

RREGULLORE PER ÇERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TE MENAXHIMIT

STATUSI I DOKUMENTIT

KOPJE E KONTROLLUAR NR.

KOPJE E PAKONTROLLUAR

Bot.	Rev.	Data	Pershkrimi	Hartoi (PSC) Dott. B.Strina	Kontrolloi (DT) Dott. A. Trapanà	Miratuar(DP) Ing. S. Russo
1 [^]	00	01.06.2015	AKREDITIMI – ISO 17021 SKEMA ISO 27001			
1 [^]	01	01.09.2016	RISHIKIM – ISO 17021:2015 SKEMA ISO 27001			
1 [^]	02	18.10.2017	PERSHTATJE MD 02: 2017 (TRANSFERIMI I ÇERTIFIKIMEVE)			
1 [^]	03	29.01.2018	PERSHTATJE MD 01:2018 (ÇERTIFIKIM I NDERMARRJEVE ME SELI TE SHUMEFISHTA)			
1 [^]	04	24.08.2018	NDRYSHIM I KAPITULLIT 6.3 SHQYRTIMI I KERKESES			
1 [^]	05	02.07.2018	ZGJERIMI I AKREDITIMIT PER SKEMAT ISO 9001- ISO 14001- ISO 45001- OHSAS 18001			
1 [^]	06	15.09.2019	RISHIKIM I DOKUMENTAVE DHE REGJISTRIMEVET TE SISTEMIT			
1 [^]	07	01.06.2020	SHTUAR NE DOK KAPITULLI 19 - SHTOJCAT 01, 02, 03 MODIFIKUAR PSC			
1 [^]	08	21.10.2020	PERDITESIM PIKA 3 3 PIKA 6 PAR.6.3			
1 [^]	09	27.04.2021	Zgjerim Akreditimit Skema ISO 37001 SHTUAR - SHTOJCA 01, 02, 03, 04			
1 [^]	10	04.04.2022	Zgjerim Akreditimit Skema ISO 50001 SHTUAR – SHTOJCA 05			

INDEKSI

2. OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT TE RREGULLORES	4
3. TERMINOLOGJIA, PERKUFIZIMET, SHKURTIMET	4
4. RREGULLIMI I PAANSHMERISE	7
5. PERGJEGJESIA	9
5.1. Te drejtat dhe detyrimet e legal cert shpk	9
5.1.1. Konfidencialiteti	9
5.1.2. Ndryshimet e rregullores	9
5.2. Te drejtat dhe detyrimet e subjektit	10
5.2.1. Aspekte te pergjithshme te marredhenies subjekt / Legal Cert shpk	10
5.2.2. Perdorimi i markes, logos dhe çertifikates	11
5.2.3. Ndryshime ne sistemin e menaxhimit te subjektit	12
5.2.4. Aksesimi ne regjistrimet e ankesave	13
5.2.5. Prania ne subjekt e inspektuesve dhe monitoruesve	13
5.2.6. Komunikimet	13
6. PROÇEDURA E ÇERTIFIKIMIT	14
6.1. Proçesi i çertifikimit	14
6.2. Kerkesa per çertifikim	15
6.3. Shyqrtimi i kerkeses per çertifikim dhe programi i auditit	15
6.4. Propozimi kontraktual per çertifikim	16
6.5. Pranimi i kerkeses per çertifikim	17
6.6. Auditimi paraprak (auditimi paraprak fakultativ)	17
6.7. Planifikimi i auditit	18
6.8. Auditimi Fillestar: FAZA 1	19
6.9. Auditimi Fillestar - faza 2	20
6.10. Veprime te metejshme pas auditit per çertifikim	22
6.11. Leshimi i çertifikimit	23
7. PROÇEDURA E MIREMBAJTJES	24
8. AUDITI I JASHTEZAKONSHEM	25
9. PROÇEDURA E RINOVIMIT TE ÇERTIFIKIMIT	26
10. VEREJTE ME SHKRIM	26
11. PEZULLIMI I ÇERTIFIKIMIT	27
12. REVOKIMI I ÇERTIFIKIMIT	28
13. ZGJERIMI / REDUKTIMI I ÇERTIFIKIMIT	28
14. AUDITI ME AFAT TE SHKURTER NJOFTIMI	29
15. HEQJA DORE NGA ÇERTIFIKIMI	29
16. TRANSFERIMI I ÇERTIFIKIMIT NGA ORGANIZMA TE TJERE ÇERTIFIKIMI	29
16.1. Shyqrtimi Paraprak	29
17. ÇERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE ME SHUME SELI	30
17.1. Shyqrtimi Paraprak	30
17.2. Metoda e Kampionimit dhe Auditit	31

18. NJOHJA RECIPROKE	32
19. CERTIFIKATA TË INTEGRUARA -TË KOMBINUARA	32
20. ANKESAT, APELIMET DHE MOSMARRVESHJET	33
20.1. Ankesat	33
20.2. Apelimet	33
20.3. Mosmarrveshjet	34
21. MBROJTJA E PRIVATESISE	34
SHTOJCA 01-RREGULLORE PER ÇERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TE MENAXHIMIT TE MJEDISIT	36
SHTOJCA 02 -RREGULLORE PER ÇERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TE MENAXHIMIT TE SHENDETIT DHE SIGURISE NE PUNE	42
SHTOJCA 03 -RREGULLORE PER ÇERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TE MENAXHIMIT TE SIGURISE SE INFORMACIONIT	50
SHTOJCA 04 - CERTIFIKIMI I SISTEMEVE TE MENAXHIMIT ANTI-RRYSHFET	56
SHTOJCA 05 - CERTIFIKIMI I SISTEMEVE TE MENAXHIMIT TE ENERGJISE	60

1. PREZANTIM I LEGAL CERT SHPK

LEGAL CERT shpk **eshte nje Organizem çertifikimi, qe vepron sipas kritereve te pergjithshme te percaktuara nga**

Standardi ISO/IEC 17021 dhe, si Organizem i pavarur, ofron per subjektet sherbime vleresimi dhe çertifikimi te konformitetit te Sistemit te tyre te Menaxhimit sipas percaktimeve te Standardit referues ISO dhe atyre te detyrueshme ne fuqi ne Shqiperi.

LEGAL CERT shpk zhvillon veprimtarine:

- Subjekteve qe paraqesin kerkese dhe marrin persiper me ane te kontrates zbatimin e kerkesave te kesaj rregulloreje;
- Pa paragjykime diskriminuese te karakterit financiar ose te nje natyre tjeter;
- Pavaresisht permasave te subjektit ose perkatesise ne çfaredolloj grupi ose shoqate.

2. OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT TE RREGULLORES

Kjo Rregullore percakton veprimtarite e çertifikimit per Sistemet të Menaxhimit: ISO 9001, ISO 27001, ISO 14001, , ISO 37001, ISO 45001, ISO 50001, qe aplikohen për Certifikim. Rregullorja e Legal Cert shpk hartohet në përputhje me dispozitat e Entit Shqiptare të Akreditimit Drejtoria E Akreditimit.

Kriteret e percaktuara per veprimtarite e çertifikimit te ushtruara sipas akreditimit zbatohen edhe per sektoret qe nuk jane objekt akreditimi. Ne fakt, qellimi i LEGAL CERT shpk, ne perputhje me politiken e saj, eshte qe te akreditoje ne menyre graduale te gjitha veprimtarite e saj.

3. TERMINOLOGJIA, PERKUFIZIMET, SHKURTIMET

Shprehjet dhe perkufizimet e perdorura ne kete katalog jane ne perputhje me standardet si me poshte:

- UNI EN ISO 9000:2005 "Sistemet e Menaxhimit te cilesise – Parimet themelore dhe terminologjia";
- UNI CEI EN ISO/IEC 17000:2005 "Vleresimi i konformitetit – Fjalori dhe parimet e pergjithshme".
- UNI EN ISO 14004: 2016: Sistemet e menaxhimit mjedisor - Udhëzime të përgjithshme për zbatimin.
- ISO 45001: "Sistemet e menaxhimit për shëndetin dhe sigurinë në punë - Kërkesat dhe udhëzuesi për përdorim";
- ISO / IEC 27000 "Vështrim i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe fjalorit";
- ISO 37001: "Sistemet e Menaxhimit për Parandalimin e Korrupsionit";
- ISO 50001 " Sistemi e manaxhimit te energjise – Kerkesa dhe udhezime ” ;
- ISO 50003 " Sistemi e manaxhimit te energjise – Kerkesat per organizmat certifikues ” ;
- ISO/IEC 17021 – 1:2015 Vleresimi i konformitetit – Kerkesat per OVK-te
- EN ISO 27006: 2013 Teknologjia e informacionit - teknikat e sigurisë - Kërkesat për organizatat certifikuese
- DA PT 001 rev. 05 Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit të akreditimit Rregullore për përdorimin e markës DA
- IAF MD 01 Çertifikimi i shoqerive me disa seli
- IAF MD 02 Transferimi i çertifikimeve
- IAF MD 03 Mbikeqyrja e rinovimit te çertifikimeve
- IAF MD 05 Afatet e auditit
- IAF MD 10 Kompetencat e burimeve njerezore
- IAF MD 11 Dokumenti për auditimet e sistemeve të menaxhimit të integruar
- IAF MD 17 Auditim në mbështetje të Organit të Akreditimit
- IAF MD 22 Application of ISO/IEC17021-1for the Certification of Occupational Health and Safety Management Systems

- IAF ID 03 Menaxhimi i jashtëzakonshëm i ngjarjeve
- IAF ID 12 Audit ne distance
- IAF ID 04 Monitorim i tregut

Standardet dhe rregulloret e përmendura me sipër kanë për referencë version në fuqi.

Janë gjithashtu të vlefshme përkufizimet e mëposhtme:

- Klient i çertifikuar : nje subjekt sistemi i menaxhimit i te cilit eshte çertifikuar;
- Paanshmeri : veprim me objektivitet (nenkupton qe nuk ekzistojne konflikte interesi, ose qe keto jane eliminuar ne menyre qe te mos ndikojne negativisht veprimtarite e organizmit te çertifikimit);
- Dhenie konsulence lidhur me sistemin e menaxhimit : pjesemarrje ne percaktimin, zbatimin dhe mirembajtjen e nje sistemi menaxhimi;
- Audit çertifikues : audit i kryer nga nje organizem çertifikimi i cili ushtron veprimtari auditimi, ne menyre te pavarur nga klienti dhe nga palet te cilat i besojne çertifikimit, qe ka per qellim çertifikimin e sistemit te menaxhimit te klientit;
- Klient : subjekt sistemi i menaxhimit i te cilit i nenshtrohet auditit me qellim çertifikimin;
- Auditor : person i cili kryen auditin;
- Kompetence : aftesi pet e zbatuar njohurite dhe per te arritur rezultatet e pritshme;
- Drejtues : person i zgjedhur nga klienti per te asistuar grupin e auditit;
- Mbiqeqyres: person i cili shoqeron grupin e auditit por nuk kryen audit;
- Fushe teknike: fushe e karakterizuar nga aspekte te perbashketa te proçeseve qe lidhen me nje tip te posaçem sistemi menaxhimi qe kane lidhje me rezultatet e pritshme nga ky sistem;
- Moskonformitet: mospermbushje e nje kriteri
- Moskonformitet I madh : moskonformitet i cili ndikon ne aftesine e sistemit te menaxhimit per te arritur rezultatet e pritura;
- Moskonformitet i vogel: moskonformitet i cili nuk ndikon ne aftesine e sistemit te menaxhimit per te realizuar rezultatet e pritura;
- Ekspert teknik: person i cili ofron i njohuri ose eksperience specifike grupit te auditit;
- Skeme çertifikimi: sistem vleresimi i konformitetit per sistemet e menaxhimit te cilit i zbatohen te njejtat kriteret specifike, si dhe te njejtat rregulla dhe proçedura specifike;
- Afat i pergjithshem i auditit: koha e nevojshme per te planifikuar dhe perfunduar nje audit te plote dhe efikas te sistemit te menaxhimit te klientit;
- Kohezgjatja e auditit çertifikues dhe e sistemit te menaxhimit: pjese e afatit te pergjithshem te auditit e shpenzuar per te kryer veprimtari audituese duke filluar nga mbledhja e hapjes deri ne ate te mbylles;
- Organizem Çertifikimi: strukturë që vepron si palë e tretë e cila vlerëson dhe çertifikon sistemin/et e menaxhimit të subjekteve të cilët paraqesin kërkesë formale në përputhje me kërkesat e publikuara dhe të zbatueshme ose me dokumentacionin e mëtejshëm të përcaktuar nga vetë sistemi;
- Çertifikimi i konformitetit: një dokument me anë të të cilit një palë e tretë e pavarur deklaron se, sipas një besueshmerie të arsyeshme, një produkt, proçes ose shërbim i caktuar, është në përputhje me një standard specifik ose me një tjetër akt ligjor;
- Audit: sinonim i Auditit ose Auditit, në këtë Manual tregon veprimtarinë e ndërmarrë nga personel i kualifikuar dhe i ngarkuar nga LEGAL CERT shpk pranë selisë së subjektit me qëllim garantimin e proçesit të lëshimit, ruajtjes ose rinovimit të Çertifikimit;
- Konstatime: shprehja e përgjithshme “Konstatime” nënkupton ato konstatime të ngritura nga grupi i auditit, i ngarkuar nga Organizmi, në kuader të auditeve të ndërmarra lidhur me subjektet dhe të formalizuara në raportet e auditit.

Konstatimet ndahen në:

- Moskonformitet I madh (MK +): Legal Cert konstaton një MK I madh kur rezultojnë nga dokumentacioni dhe/ose zbatimi i Sistemit të Menaxhimit, mospermbushja e një kriteri të përcaktuar nga standardi të cilit i bëhet referim, të kërkesave të detyrueshme ligjore, rregulloreve të LEGAL CERT shpk dhe rregulloreve të tjera të zbatueshme dhe që mund të cenojnë vlefshmerinë dhe/ose funksionimin përveçse mund të ndikojnë negativisht në aftesine e sistemit të menaxhimit për të realizuar rezultatet e pritshme.
- Moskonformitet I vogel (MK -): Legal Cert sinjalizon një Moskonformitet I vogel kur rezultojnë se nuk është përmbushur një kriter i përcaktuar nga standardi referues, nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara nga ligji, rregulloret e Legal Cert dhe rregulloret e Drejtorisë së Akreditimit – edhe pse ky është tregues

i nje sjellje te papershtatshme dhe qe ka nevoje per nje veprim korrektiv – i tille qe uk cenon vlefshmerine dhe/ose funksionimin e Sistemit te Menaxhimit ose qe nuk gjeneron dyshime serioze lidhur me zbatimin e kerkesave te parashikuara nga standardi per te cilin subjekti ka kerkuar çertifikimin.

- Komete (KOM): një Konstatim i ngritur nga LEGAL CERT shpk klasifikohet si Koment kur verifikohet, sipas gjykimit të grupit të auditit (GA) mundësia e rekomandimeve ose e përmirësimeve në dokumentacionin dhe/ose zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Organizmit përveç rasteve të përputhshmërisë dhe vlefshmërisë së tij. Sa më sipër nuk është pasojë e një situatë të mungesës së përmbushjes së një kriteri, por ka për qëllim të parandalojë që kjo situatë të verifikohet (përsa kohë konsiderohet e mundshme) dhe/ose dhënien e udhëzimeve për përmirësimin e funksionimit të Sistemit. Nuk kërkohet që subjekti të ndërmarrë asnjë veprim korrigjues edhe pse gjatë auditit pasardhës do të verifikohet nëse Komentet kanë qënë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga ana e subjektit dhe për pasojë eventualisht të marra parasysh;
- Administrimi i Konstatimeve: veprimtari i cila duhet të kryhet nga subjektet në përputhje me Konstatimet e paraqitura nga LEGAL CERT shpk; të gjitha Konstatimet e paraqitura nga LEGAL CERT shpk në përfundim të një auditit duhet t'i nënshtrohen një trajtimi të përshtatshëm dhe ndërmarrje veprimesh korrigjuese nga ana e subjektit, sipas kushteve të përcaktuara.
- Veprimet korrigjuese: veprim i ndërmarrë nga subjekti, në vijim të analizimit të shkaqeve të cilat shkaktojnë formulimin e Konstatimit nga Organizmi me qëllim eliminimin e këtyre shkaqeve.

Përmbyllja e Konstatimeve do të verifikohet nga Grupi i auditit gjatë auditit të parë.

SHKURTIME

MQ	Manuali i Cilësisë
PO	Procedura Operative
REG	Rregullore e Brendshme
IT	Instrukcion teknik
SC	Sistem i Cilësisë
RKI	Raport i Auditit
MK+	Moskonformitet i madh
MK-	Moskonformitet i vogel
KOM	Koment
VK	Veprim Korrigjues
KI	Audit
A-PAR	Audit Paraprak
A-INI	Audit i Çertifikimit
A-M1	A I i Mirembajtjes se 1°
A-M2	A I i Mirembajtjes se 2°
A-1-RIN	V I di 1° Rinovimit
A-2-RIN	V I di 2° Rinovimit

A-3-RIN	K I i Rinovimit te 3°
A-STR	Audit i Jashtëzakonshëm
A-NM	Audit per ndryshim marke
A-EST/RID	Audit per zgjerim/reduktim qellimi
GA	Grupi i Auditit
PGA	Përgjegjësi i grupit të Auditit
AA	Anëtar i grupit të Auditit
OBS	Vezhgues
ET	Ekspert Teknik
PS	Përgjegjës i Skemës
RGA-add	Përgjegjës i grupit të Auditit në proces trajnimi
AA - add	Ndihmës i Auditit në proces trajnimi
DP	Drejtor i Përgjithshëm
DT	Drejtor Teknik
PSC	Përgjegjës i Sistemit të Cilësisë
OÇ	Organizëm Çertifikimi
KRP	Komiteti për Ruajtjen e Paanshmërisë

Në këtë rregullore termi "Audit i mirëmbajtjes" është sinonim i "Auditit të Mbikëqyrjes".

Kjo Rregullore i shpendahet subjekteve te interesuara mbi veprimtarine e LEGAL CERT shpk te cilat paraqesin kerkesa.

Te gjitha dokumentet e LEGAL CERT shpk, regjistrimet e sistemit dhe auditet, ashtu si dhe veprimtarite e auditit hartohen dhe kryhen ne dy gjuhe (shqip dhe italisht).

4. RREGULLIMI I PAANSHMERISE

Qe nga momenti i krijimit te LEGAL CERT shpk si Organizem Çertifikimi, themeluesit e saj i kane dhene shoqerise orientime te sakta dhe kufinjte qe nuk duhen tejkaluar, te percaktuar mbi bazen e ndershmerise dhe eksperienes personale, me qellim qe te ruhet dhe shprehet ne kohe imazhi i ndershmerise, korrekteses dhe reputacionit te mire

qe kane dashur t'i transferojne shoqerise, edhe pse te ndergjegjshem qe pasuria e saj rrjedh nga Organizmat qe i drejtohen asaj.

Organet drejtuese te LEGAL CERT shpk, duke marre parasysh se ushtrojne nje veprimtari themeli i se ciles qendron ne besimin qe çertifikimet e leshuara nga Organizem Çertifikimi kane ne treg, ne komunitet dhe palet e interesuara, pasi leshohen nga nje subjekt pale e trete e pavarur dhe kompetente, merr persiper qe te ndjeke ne menyre konstante politiken e saj e cila bazohet ne parimet qe vijojne:

- Ushtrimin e veprimtarise se Çertifikimit te Sistemeve te Menaxhimit dhe konformitetit sipas normave te detyrueshme, me paanshmeri ne gjykim dhe objektivitet ne proceset e vleresimit, ne zbatim te interesit me te larte te paleve te perfshira;
- Ushtrimin e procesit te Çertifikimit ne perputhje me sa parashikohet nga legjislacioni i zbatueshem perveç asaj çka kerkohet nga DA;
- Realizmin e nevojave te tregut, te paleve te interesuara (prodhues e konsumatore) dhe te interesit te komunitetit ne menyre qe te perceptohet si subjekt i paanshem dhe i pavarur;
- Ushtrimin e veprimtarise se saj me rigorozitet, ndershmeri dhe paanshmeri, ne perputhje me te dhenat objektive realiste, duke garantuar gjithnje profesionalizem maksimal dhe pergatitje te burimeve njerezore te angazhuara;
- Garantimin e kapacitetit per te konstatuar dhe degjuar nevosa e paleve te interesuara ne respekt reciprok te te gjitha paleve te perfshira;
- Shprehjen, nepermjet qendrimeve deontologjikisht korrekte, te gjykimeve serioze, profesionale dhe te bazuara gjithnje mbi te dhena dhe prova objektive.

LEGAL CERT shpk, me qellim ruajtjen e paanshmerise ne veprimtarite e veta te çertifikimit, mund te parasihkoje ne orgamogramen e saj funksionale pranine e nje komiteti per ruajtjen e paanshmerise (KRP), nje organ i pavarur dhe i paanshem, i cili perfaqeson interesat e paleve ne procesin e vleresimit dhe çertifikimit: kliente te klienteve, organe publike dhe universitete, shoqata konsumatoresh.

KRP ka funksionin te garantoje zbatimin korrekt te kushteve dhe permbajtjes se kesaj rregulloreje.

LEGAL CERT shpk, me qellim garantimin e korrekteses dhe transparences maksimale ne ushtrimin e veprimtarise se saj te çertifikimit, nuk ofron sherbime keshillimore lidhur me percaktimin dhe zbatimin e sistemeve te menaxhimit me standardet ISO në të cilat Legal Cert kryen certifikimin, perveç veprimtarise se zakonshme te informimit dhe/ose asistences per subjektet e çertifikuara ose ne proces çertifikimi.

Per te siguruar mungesen efektive te veprimtarive keshillimore, LEGAL CERT shpk kerkon Ekstrakte Historike te leshuara nga Regjistri Tregtar te strukturave qe mund te nderveprojne me organizmin.

LEGAL CERT shpk me qëllim përmbushjen e qëllimit parësor të Çertifikimit, ose me qëllim krijimin e besimit tek të gjitha palët e përfshira dhe të interesuara në procesin e Çertifikimit që një Sistem Menaxhimi të përmbushë kriteret e përcaktuara, vepron në përputhje me parimet që janë:

- Paanshmëria;
- Profesionalizmi;
- Përgjegjshmëria;
- Transparenca;
- Konfidencialiteti;
- Përgjigja e shpejtë dhe efikase ndaj ankesave;
- Qendrimi i bazuar ne rrezik.

Keto parime, qe konsiderohen te nevojshme per veprimtarite e kryera nga Organizmi, perbejne bazen per kriteret e metejshme te veprimtarise dhe pershkruese qe LEGAL CERT shpk percakton ne kete dokument dhe sherbejne si udhezues per vendimet qe mund te rezultojne te nevojshme ne rast situatash te paparashikuara dhe vendimeve urgjente.

Legal Cert merr ne konsiderate rreziqet qe lidhen me dhenien e nje çertifikimi profesional, koherent dhe te paanshem.

Rreziqet mund te perfshijne:

- Objektivat e auditit;
- Kampionimin e perdorur gjate procesit te auditit;
- Paanshmerine reale dhe ate te perceptuar;
- Çeshtje qe kane te bejne me pergjegjesine juridike dhe te natyres detyruese;
- Subjektin klient qe I nenshktrohet auditit dhe ambientin e tij operativ;
- Ndikimin e auditit mbi klientin dhe veprimtarine e tij;
- Shendetin dhe sigurine e grupit te auditit;
- Perceptimin e paleve te interesuara;
- Deklaratat mashtruese nga ana e klientit te çertifikuar
- Perdorimin e markes.

Marredheniet me jashte te LEGAL CERT shpk kufizohen ne bashkepunime me struktura te cilat ushtrojne veprimtari vleresimi si pale te treta per Sistemet e Menaxhimit ose me struktura te cilat nuk cenojne paandhmerine dhe pavaresine e OVK-se.

LEGAL CERT shpk garanton qe personeli i brendshem dhe ai i jashtem i angazhuar gjate veprimtarise se çertifikimit te mos kete ofruar asistence per zbatimin e Sistemit te Menaxhimit ose per pergatitjen e dokumentacionit te tij ose te mos kete kryer ne ndonje forme veprimtmari prane dhe per llogari te subjektit prane te cilit eshte angazhuar me pune nga Organizmi.

Paanshmeria e Organizmit i besohet kryesisht veprimtarise se vleresuesve te saj dhe rreziqet lidhur me paanshmerine e nje auditori jane burime te mundshme shtremberimesh ose mosveprimesh te cilat mund te kompromentojne aftesine e vete Organizmit per te mberritur ne perfundime objektive dhe te perseritshme lidhur me Subjektet qe i nenshtrohen Auditit.

LEGAL CERT shpk ka marre ne konsiderate keto rreziqe te mundshme qe vijne si rrjedhoje e interesave personale, vete vleresimeve, marredhenieve familiare ose marredhenieve te ngushta me ndermarrjen qe i nenshtrohet auditit ose si pasoje e kercenimeve ne menyre pak a shume te shprehur dhe, per te mbrojtur paanshmerine e auditoreve, ushtron nje veprimtari parandaluese dhe formuese e tipit te pergendruar.

LEGAL CERT shpk me qellim parandalimin e sjelljeve te papershtatshme ka hatuar nje kod etik te sjelljes profesionale i cili i vihet ne dispozicion secilit auditor ne momentin kur hyn ne marredhenie me Organizmin.

Gjithashtu, per çdo veprimtari vleresimi te planifikuar, LEGAL CERT shpk kerkon marrjen persiper me shkrim te mungeses se konfliktit te interesit nga secili anetar i grupit te auditit te emeruar.

LEGAL CERT shpk nuk ia beson veprimtarine e auditit subjekteve te cilat ofrojne sherbime keshillimore ne fushem e Sistemeve te Menaxhimit, dhe ne fakt vleresimet kryhen nga auditore te brendshem, te jashtem dhe eksperte teknike qe veprojne si profesioniste te lire, te pajisur me kontrate te rregullt bashkepunimi me LEGAL CERT shpk

Organizmi, me qellim shmangen e konflikteve te interesit dhe ruajtjes se lirise nga çdo interes qe mund te shtyje anetaret e nje grupi vleresimi qe te veprojne ne menyre te njeanshme, siguron qe te mos perdoren, gjate auditeve ose veprimtarive te tjera gjate procesit te Çertifikimit, personel i veti dhe/ose bashkepunetore te jashtem te cilet kane kryer veprimtari keshillimore lidhur me ate Sistem Menaxhimi brenda nje periudhe prej tre vitesh nga perfundimi i veprimtarise keshillimore

LEGAL CERT shpk, ne perputhje me politikat e veta, i kerkon personelit te vet, te brendshem dhe te jashtem, te informoje Organizmin lidhur me çdo situatë per te cilën është ne dijeni dhe që mund të përbejë konflikt të mundshëm interesi, për ata vete ose për Organizmin e Çertifikimit.

5. PERGJEGJESIA

Kjo rregullore përcakton në mënyrë të detajuar rolet dhe përgjegjësitë e paleve të përfshira në procesin dhe metodologjinë e veprimit që LEGAL CERT shpk dhe subjekti klient duhet të zbatojnë gjatë marrëdhënies së tyre kontraktore në lidhje me veprimtarinë e çertifikimit të Sistemeve të Menaxhimit dhe zbatimin e legjislacionit të aplikueshem.

Subjekti klient dhe jo organizmi i çertifikimit, ka përgjegjësinë e përbushjes së kërkesave lidhur me çertifikimin. Organizmi i çertifikimit ka përgjegjësinë që të vlerësojë mjaftueshmërinë e të dhenave objektive mbi të cilat bazohet vendimi i çertifikimit. Mbi bazën e përfundimeve të auditit, organizmi merr vendimin për dënieën e çertifikimit nëse ka mjaftueshem prova për konformitetin ose të mos e japë, nëse këto prova nuk ekzistojnë.

5.1. Te drejtat dhe detyrimet e legal cert shpk

5.1.1. Konfidencialiteti

LEGAL CERT shpk garanton nëpërmjet sistemeve informatike, pajisjeve, mjeteve dhe procedurave operative (PO – 01 “Mënyra të menaxhimit të Dokumenteve dhe të Rregjistrimeve) të përshtatshme, që informacionet e marra gjatë gjithë aktivitetëve të Çertifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të subjekteve kliente (psh dokumentacion teknik dhe kontraktor, letra, korrespondenca etj) të mbeten tërësisht të rezervuara dhe konfidenciale në të gjitha nivelet e struktureve të saj, të përfshirë këtu dhe anëtarët e Komitetit për Ruajtjen e Paanshmërisë (KRP) nëse ka një të tillë; në rast të jashtëzakonshme kur publikimi i informacioneve konfidenciale kërkohet si përbushje e detyrimeve ligjore ose me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit ose ndonjë autoriteti tjetër të cilat detyrojnë dënieën e informacionit të marre nga LEGAL CERT shpk prej klientëve të saj, organet drejtuese informojnë subjektin lidhur me të dhenat që i janë publikuar paleve të treta, përveç kur ligji përcakton ndryshe. Një kopje e këtij njoftimi ruhet në dosjen e subjektit.

Përsa i përket trajtimit të të dhenave, në perputhje me parashikimet ligjore të zbatueshme në fushën e mbrojtjes së të dhenave personale, LEGAL CERT shpk garanton zbatimin e kërkesave të konfidencialitetit për të gjithë personelin që vepron për llogari të saj, të brendshëm dhe të jashtëm, në perputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshem dhe kodit të vet të etikës.

Marrja e çertifikates së konformitetit për Sistemin e Menaxhimit nga ana e subjektit kërkues, i jep të drejtën organizmit që të pasqyrojë emrin e subjektit të çertifikuar në listën e klientëve të çertifikuar; në perputhje me kërkesat e detyrueshme lidhur me mbrojtjen e të dhenave personale, nënshkrimi i kontratës me LEGAL CERT shpk (modeli SI- 02 ITA , SI- 02 AL i sistemit) përben autorizim për publikimin në regjistrin e posaçëm të të dhenave të subjektit siç përcaktohet në dispozitën e posaçme kontraktore.

Lista e klientëve të çertifikuar është e disponueshme në faqen zyrtare të internetit të Organizmit: www.legacert.al.

Në perputhje me politiken e vet mbi konfidencialitetin, LEGAL CERT shpk i trajton informacionet e mundshme lidhur me klientet, të cilat i ka marre nga burime të ndryshme nga vete klienti (ankesa, informacione nga organe publike etj) si informacione konfidenciale.

5.1.2. Ndryshimet e rregullores

LEGAL CERT shpk dërgon, bashkëlidhur ofertës, komunikimin lidhur me disponueshmërinë e kesaj rregulloreje në

versionin e saj te fundit, me qellim qe t'i lejoje subjektit konsultimin me te drejta e detyrimet e lidhura me pranimin e ofertes. Kjo Rregullore eshte e disponueshme per subjektet e certifikuar apo ne proces certifikimi ne faqen zyrtare te Organizmit www.legalcert.al, duke përdorur kriterin e Miratimit te Heshtur si pranim, ose me kerkese te subjektit do t'i dergohet atij nepermjet postes elektronike.

LEGAL CERT shpk ka te drejte te ndryshoje sistemin e certifikimit te pershkruar ne kete rregullore, ne vijim te riorganizimit te brendshem apo ndryshimeve te rregullave te akreditimit. Ne keto raste subjekteve te certifikuar, i jepet nepermjet njoftimit me shkrim, kur eshte i zbatueshem, nje afat kohor i arsyeshem per t'u adaptuar me ndryshimet e kryera ne krieteret e certifikimit te percaktuara ne kete rregullore.

Ndryshimet e kryera ne tekst trajtohen sipas procedures se percaktuar ne PO 01 "Proçesi i administrimit te dokumenteve dhe regjistrimeve"

Ndryshimet eventuale ne kete Rregullore i vihen ne dijeni edhe Komitetit per Ruajtjen e Paanshmerise (KRP).

LEGAL CERT shpk vë në dispozicion të subjekteve të certifikuar dhe/ose ne proces certifikimi një kopje të rregulloreve të certifikimit në fuqi përmes botimit në faqen e internetit të kompanisë (www.legalcert.al), duke përdorur kriterin e Miratimit te Heshtur si pranim.

5.2. Te drejta dhe detyrimet e subjektit

5.2.1. Aspekte te pergjithshme te marredhenies subjekt / Legal Cert shpk

Subjekti ka te drejten te publikoje marrjen e certifikimit te sistemit te vet ne menytrat qe konsideron me te arsyeshme, dhe ne çdo rast ka detyrimin te respektojë parashikimet e Rregullores per perdorimin e logos se certifikimit LEGAL CERT shpk derguar çdo subjekti te certifikuar.

Çertifikimi i leshohet subjektit vetem per veprimtarite e certifikuar dhe selite (njesite operative) e percaktuara ne certifikate dhe nuk eshte e transferueshme ose e zbatueshme tek njesi te tjera.

Subjekti i certifikuar merr persiper qe:

- Te mbaje organizimin ne perputhje me kriteret e zbatueshme lidhur me sistemin e menaxhimit te zgjedhur si referim dhe per te cilin ka marre certifikimin;
- Te siguroje zbatimin e aspekteve ligjore dhe te detyrueshme te cilat prekin ne menyre te drejtperdrejte perputhshmerine e produktit/sherbimit objekt certifikimi;
- Subjekti ka per detyre te zbatoje kete REG - 1 "Rregullore per Çertifikimin e Sistemeve te Menaxhimit" dhe shtojcat bashkengjitur;
- Subjekti ka per detyre te zbatoje permbajtjen e Rregullores REG – 2 "Perdorimi i markes se certifikimit" ku specifikohen edhe kriteret e perdorimit e markes se DA-se;
- Te mbaje kopje te dokumentacionit te Sistemit te vet te Menaxhimit ne dispozicion te GKI prane subjektit;
- Te deklaroje se eshte certifikuar ne menyre ekskluzive per ato veprimtari per te cilat eshte leshuar certifikimi dhe te zbatoje REG 02 lidhur me referencat ne gjendjen e vet te certifikimit;
- Te pranoje, me shpenzimet e veta, auditet qe do te jene te nevojshme per mbajtjen e certifikimit ne vijim te ndryshimeve organizative te rendesishme te cilat kane ndodhur pas dates se leshimit te certifikimit ose pas auditit te fundit mbikeqyres te kryer;
- Te vere ne zbatim veprimet korrektive lidhur me sistemit e vet te menaxhimit per cilesine ne vijim te ndryshimeve te konstatuara;
- Te mos perdore certifikimin ne menyre qe te demtoje imaxhin e LEGAL CERT shpk ose te mos leshoje deklarata te cilat mund te konsiderohen si mashtruese ose te tilla qe mund te cenojne besimin e publikut;
- Ne rast pezullimi, shfuqizimi ose heqje dore nga certifikimi, te pushoje perdorimin e materialeve publicitare qe

permbajne referime te shprehura ne zoterimin e çertifikimit;

- Te ndryshoje te gjitha materialet publicitare ne rast se fusha e zbatimit te çertifikimit eshte reduktuar;
- Te mos lejoje qe referencat tek çertifikimi i sistemit te vet te menaxhimit te perdoren ne menyre te tille qe te lene te kuptohet sikur Organizmi çertifikon nje produkt ose nje proces;
- Te mos lere te kuptohet qe çertifikimi i zbatohet veprimtarive te cilat jane jashte fushes se zbatimit te çertifikimit;
- Te mos kryeje, dhe as te lejoje kryerjen e deklaratave pohuese te cilat mund te çojne ne mashtrim lidhur me çertifikimin e saj ose te mos perdore dokumentin e çertifikimit ose te nje pjese te tij ne menyre mashtruese;
- T'i komunikoj Organizmit ndryshimet lidhur me aspekte qe mund te ndikojne ne kapacitetin e sistemit te menaxhimit per te vazhduar te permbushje kriteret e standardit te perdorur per çertifikimin (ndryshim pronesie, objekti te shoqerise, adresave te selive objekt çertifikimi, fushes se zbatimit te sistemit, teknologjise se proceseve prodhuese, ndryshime thelbësore te dokumentacionit te sistemit etj.).

Çertifikimi i leshuar nga LEGAL CERT shpk nuk e çliron subjektin nga detyrimet ligjore qe rrjedhin nga produktet, proceset dhe shërbimet e ofruara dhe ato kontraktuale kundrejt klienteve te tij.

Veçanerisht nenvizohet se asnje pergjegjesi nuk mund te vije per LEGAL CERT shpk nga defekte te produkteve, proceseve dhe shërbimeve te ofruara nga subjekti ne favor te te treteve.

LEGAL CERT shpk nuk eshte pergjegjes per papershtatshmerite ose demet qe shkaktohen si rrjedhoje e veprimtarise se subjektit ose produkteve, proceseve ose shërbimeve te ofruara prej tij. Ndryshimet organizative dhe strukturore qe subjekti kryen per te marre çertifikimin jane pergjegjesi ekskluzive e vete subjektit.

5.2.2. Perdorimi i markes, logos dhe çertifikates

Logo dhe marka eshte pronesi ekskluzive e Organizmit te Çertifikimit LEGAL CERT shpk dhe ndalohet perdorimi pa autorizimin e shprehur dhe me shkrim te tij.

Subjekti garanton se marka do te perdoret per qellime publicitare, mbi dokumentacionin kontraktor, ne letren me koke etj, me kusht qe ky perdorim te mos shkaktoj ne interpretime mashtruese.

Perdorimi i markes lejohet per subjektet juridike dhe nuk mund t'i cedohet te treteve ose pasardhesve, pa autorizimin e shprehur te LEGAL CERT shpk dhe as nuk mund te transferohet si rrjedhoje e ekzekutimit te detyrueshem.

Perdorimi i markes duhet te ndodhe sipas kushteve te percaktuara ne kete dokument dhe veçanerisht ne zbatim te Rregullores perkatese per perdorimin e logos/markes se çertifikimit te LEGAL CERT SHPK (REG – 02), derguar nga subjekti bashke me Çertifikaten e konformitetit. Kjo rregullore perfshin edhe zbatimin e kriterëve te parashikuara per perdorimin e markes nga DA, ne versionin e zbatueshem.

Ne pergjithesi subjekti i çertifikuar:

- Nuk mund te perdore marken DA ne menyre te ndare nga marka e çertifikimit LEGAL CERT shpk;
- Nuk mund te perdore marken DA ne menyre qe te lere te kuptohet se DA ka çertifikuar ose miratuar sistemin e menaxhimit te shoqerise, ose produktin apo personelin e nje perfituesi te çertifikimit te akredituar, ose ne ndonje menyre tjeter te palejuar;

Konsiderohet jokorrekt perdorimi kur çertifikimi, logo dhe marka:

- perdoren perpara dorezimit te çertifikates nga ana e LEGAL CERT shpk;
- perdoren ne menyre te tille qe mund te interpretohet si çertifikim dhe/ose marke konformiteti per produktet/shërbimet;
- perdoren pertej afatit te vlefshmerise se çertifikimit;
- perdoren pavaresisht masave te pezullimit, reduktimit dhe shfuqizimit;
- ne rast se subjekti ka hequr dore nga çertifikimi;

Marka duhet te perdoret ne formen qe iu dergohet subjekteve te interesuara, sipas ngjyrave te percaktuara ose ne bardhe e zi dhe duhet te jete lehtesisht e lexueshme dhe e dallueshme. Marka mund te perdoret ne çfaredolloj mase, duke respektuar permasat e secilit element te logos.

Perdorimi korrekt i çertifikates, markes dhe çdo forme tjeter referimi tek çertifikimi verifikohet ne menyre konstante nga auditoret e LEGAL CERT shpk gjate auditeve te mbikeqyrjes dhe/ose rinovimit.

Çertifikimi nuk mund te perdoret ne menyre te tille qe te konsiderohet i vlefshem edhe per sisteme te tjera menaxhimi te pambuluar nga fusha e zbatimit te çertifikates se leshur dhe/ose per veprimtari te ndryshme nga ato per te cilat eshte leshuar. Njesite opertive (selite, kantiret, fabrikat, filialet, deget etj) te perfshira ne sistemin e menaxhimit te çertifikuar, duhet te pasqyrohen me adresat e plota.

Kudo qe te jete duhet te rezultojte ne menyre te warte qe çertifikimi i sistemit te menaxhimit eshte i kufizuar per seline/te dhe/ose fabriken/at prodhues/e te percaktuar/a ne çertifikate. Nese eshte e mundur, gjithashtu, duhet te permendet numri i çertifikates.

Subjekti i çertifikuar duhet te nderprese perdorimin ose çdo perdorim tjeter te dokumenteve te çertifikimit dhe te logos e markes LEGAL CERT shpk si pasoje e: perfundimit, pezullimit, shfuqizimit, heqjes dore me pasoje terheqjen e çertifikimit.

Subjekti duhet te korrigoje te gjithë materialin publicitar ne rast se fusha e zbatimit te çertifikimit reduktohet; nuk duhet te lere te kuptohet se çertifikimi zbatohet per veprimtari te cilat jane jashte fushes se zbatimit te çertifikimit.

5.2.3. Ndryshime ne sistemin e menaxhimit te subjektit

Gjate periudhes se vlefshmerise se çertifikimit te leshuar, subjekti duhet te njoftoje me shkrim (nepermjet faksit, letres ose postes elektronike) LEGAL CERT shpk per çdo ndryshim thelbesor (organizativ dhe/ose dokumentar) te sistemit te tij te menaxhimit duke pershkruar natyren e dhe llojin e ndryshimit te kryera, sipas menyrave te pershkruara me siper.

Me marrjen e kerkeses LEGAL CERT shpk merr masat per nisjen e proçedurave per marrjen e vendimit lidhur me çeshtjen.

Mospermbushja e ketyre kushteve mund te shkaktojte pezullimin e çertifikimit sipas menyrave te parashikuara nga kjo rregullore.

a) NDRYSHIME TREGTARE

Ne rast ndryshimesh ne aspektin tregtar, blerje/shitje e deges se veprimtarise, bashkim shoqerish, subjekti i çertifikuar duhet t'i jape njoftim te menjehershëm LEGAL CERT shpk, duke i derguar kopje te dokumentacionit zyrtar i cili verteton kete ndryshim (akt noterial, ekstrakt te shoqerise etj.).

Drejtoria proçedon me shqyrtimin e kontrates perpara leshimit/perditesimit te çertifikates dhe, nese e konsideron te nevojshme, ka te drejte te kerkoje nje KI te jashtezakonshem sipas menyrave te parashikuara ne kete rregullore, duke rene dakord paraprakisht me subjektin lidhur me daten dhe shumen.

Ne rast nisje proçedurash falimentimi, vullnetare ose te detyrueshme, subjekti duhet te njoftoje ne menyre te menjehershme LEGAL CERT shpk.

Ne rast administrimi te kontrolluar dhe vazhdimi te veprimtarise, Drejtoria ka te drejte te kerkoje nje Audit te jashtezakonshem sipas menyrave te parashikuara ne kete rregullore.

b) NDRYSHIME TE DOKUMENTACIONIT TE SISTEMIT TE MENAXHIMIT

ne rast ndryshimes thelbesore organizative dhe/ose dokumentare te cilat ndikojne ne sistemin e çertifikuar (psh.: ndryshim i obejktit te çertifikimit, botim i ri i Katalogut, ndryshim i struktures se Sistemit, futje e proçeseve te reja, etj), subjekti eshte i detyruar t'i komunikojte LEGAL CERT shpk kete ndryshim; Drejtoria, ne rast se e konsideron te nevojshme, ka te drejte te kerkoje nje KI te jashtezakonshem sipas menyrave te parashikuara ne kete rregullore, te paraprire nga nje Shqyrtim i mundshëm Dokumentacioni.

Ne rast ndryshimesh dokumentare te sistemit te cilat nuk kane ndikim ne objektin e çertifikimit dhe/ose te nje niveli te ulet (psh.: perditetim i detyrave, ndryshim pozicionesh etj.), kopje e manualit qe i eshte dhene ne menyre te kontrolluar LEGAL CERT shpk dhe qe ruhet tek subjekti, duhet te perditetohet rrjedhimisht.

Dokumentacioni i vjeter duhet sidoqofte te ruhet per efekt auditi nga ana e PGA per veprimtarite e zakonshme te auditit: eshte detyre e PGA te mbledhe formatin elektronik vetem te Manualit qe eshte depozituar prane Sekretarise se Pergjithshme bashkengjitur Raportit te Auditit per perditetimin e dosjes se subjektit te ruajtur prane selise se LEGAL CERT shpk.

5.2.4. Aksesi ne regjistrimet e ankesave

Subjekti duhet te percaktoje menytrat dhe pergjegjesite per trajtimin e ankesave lidhur me produktet/sherbimet qe bejne pjese ne objektin e çertifikimit te kerkuar. Regjistrimet lidhur me ankesat duhet te arkivohen ne menyre progresive dhe, ne rast auditi, duhet te jene ne dispozicion te auditoreve te LEGAL CERT shpk si dhe te perfaqesuesve te DA-se nese çertifikimi bej pjese ne sektoret e akredituar.

Nenvizohet se per aneksat e marra nga klienti, subjekti duhet te kryeje te pakten:

- regjistrimin dhe ndermarrjen e hetimeve te arsyeshme lidhur me keto ankesa;
- ndermarrjen dhe regjistrimin e veprimeve korrektuese te arsyeshme.

5.2.5. Prania ne subjekt e inspektuesve dhe monitoruesve

Subjekti, pa cenuar kriteret e konfidencialitetit, duhet t'i lejoje hyrjen ne ambientet e tij, vleresuesve te LEGAL CERT shpk, monitoruesve te mundshem ose eksperteve teknike qe i perkasin Grupit te Auditit dhe inspektoreve te mundshem te DA-se, si dhe t'i asistojte gjate auditeve.

Subjekti ka te drejte te refuzoje, duke dhene arsytet me shkrim, ekspertet ose anetaret e GA te propozuar per kryerjen e auditit, brenda 5 diteve nga marrja e komunikimit mbi perberjen e grupit te auditit (perjashtuar auditet me afat te shkurter paralajmerimi).

Ne rast se verifikohet ky rast, do te jete detyre e Organizmit qe te rishikojte anetaret e GA dhe t'ia paraqese serish subjektit per pranim.

LEGAL CERT shpk angazhon dhe auditore apo eksperte te jashtem. Sipas kerkeses, vihen ne dispozicion dhe informacione baze lidhur me çdo anetar te GKI.

Refuzimi i subjektit per te pritur monitoruesit e DA-se qe shoqerojne GKI te LEGAL CERT shpk, edhe me afat minimal, perben arsye per mosleshimin, per pezullimin ose shfuqizimin e çertifikimit.

Eshte e drejte e subjektit te ftojte per te asistuar gjate auditeve monitoruesit e tij (psh.: konsulentet e jashtem); kusht i nevojshem qe PGKI te jape miratimin per pranine e tyre eshte respektimi i rolit, ose qe ata te mos nderhyjne ne menyre aktive gjate procesit te auditit. Ne rast se nuk respektohet roli, eshte e drejte e PGA te kerkoje largimin e menjehershem.

Subjekti, ne baze te llojit te percaktimeve ligjore ne fushen e mbrojtjes se shendetit, sigurise dhe higjienes ne pune, eshte pergjegjes per zbatimin e masave parandaluese dhe te emergjences edhe per GA.

Subjekti duhet te pranoje kryerjen e Auditeve Inspektuese, veprimtari e kryer nga DA si shqyrtim i dokumenteve te sistemit te menaxhimit te çertifikuar, perfsjete dokumentet e auditit te leshaura nga OVK. Gjate Auditeve Inspektuese, ne prani te personelit te OVK-se, inspektoret mund ti drejtojne pyetje personelit te subjektit te çertifikuar.

5.2.6. Komunikimet

Subjekti, perveç sa parashikohet ne paragrafin 5.2.1, duhet te informoje ne menyre te menjehershme LEGAL CERT shpk nepermjet faksit ose postes elektronike dhe me pas nepermjet postes se regjistruar çdo sinjalizim te komunikuar nga publiku dhe/ose Organet Publike lidhur me mospermshjet ligjore, ndryshimet e ligjit, dispozitave rregulluese qe e prekin ate, si dhe, ne rast procesesh gjyqesore, per pergjegjesi nga produktet ose shkelje te ligjit per produktet/sherbimet per te cilat eshte dhene çertifikimi.

LEGAL CERT shpk, ne rast se informohet nga dokumente zyrtare, duhet t'ia komunikojë rrethanat e cituara me siper, Komitetit te Ruajtjes se Paanshmerise si dhe DA-se e cila do te marre masa per trajtimin e komunikimit ne meynren e duhur.

LEGAL CERT shpk, me qellim permbushjen e dispozitave ligjore te caktuara dhe/ose Rregulloreve te zbatueshme, mund t'i komunikojë paleve te treta gjendjen e vlefshmerise se çertifikimeve te dhena.

6. PROÇEDURA E ÇERTIFIKIMIT

6.1. Proçesi i çertifikimit

Skema e proçesit te çertifikimit e adoptuar nga LEGAL CERT shpk renditet sipas fazave te meposhte:

- 6.2 Kerkesa per çertifikimi
- 6.3 Shqyrtimi, vleresimi i kerkeses per çertifikim dhe hartimi i programit te auditit
- 6.4 Propozimi kontraktor per çertifikimin
- 6.5 Pranimi i kerkeses per çertifikim
- 6.6 Auditi paraprak (fakultativ)
- 6.7 Planifikimi i veprimtarive te auditit
- 6.8 Auditi fillestar – Faza 1: Shqyrtimi i dokumentacionit dhe inspекtimi fillestar
- 6.9 Auditi fillestar – Faza 2: Auditi çertifikimit perfshire auditet e metejshme ose shtese per verifikimin e veprimeve korrektuese te kerkuara
- 6.10 Veprime te metejshme pas auditit fillestar te çertifikimit
- 6.11 Dhenia e çertifikimit

Kane te drejte per marrjen e çertifikimit nga LEGAL CERT shpk te gjitha subjektet, e cilesdo natyre dhe permase, te cilat i paraqesin LEGAL CERT shpk nje kerkesa per marrje preventivi dhe te cilat marrin persiper te zbatojne sa parashikohet ne kete rregullore ne versinin e fundit te zbatueshem te saj.

Proçesi i çertifikimit fillon me marrjen e “kerkeses per preventiv” dhe artikullohet ne fazat e pershkruara ne menyre te detajuar nga proçedura operative PO-04 “Menyrat e administrimit te proçesit te vleresimit dhe çertifikimit”

Subjektet te kerkojne nisjen e proçedurave te çertifikimit duhet te permbushen kushtet e meposhtme:

1. te zoterojne nje sistem menaxhimi i cili permbush kriteret e standardit referues dhe legjislacionit te zbatueshem
2. te zoteroje nje sistem te zbatuar dhe aktiv mbi shitjet prej te pakten tre muaj;
3. te kete kryer te pakten nje cikël auditit te brendshme lidhur me te gjithë llojet e proçeseve te veprimtarise sipas menyrave te parashikuara nga standardi referues;
4. te kete kryer te pakten nje vleresim te drejtorise sipas menyrave te parashikuara nga standardi referues;
5. te pranoje rregullat e percaktuara nga kjo rregullore(REG 01) dhe kushtet kontraktore te komunikuar nga LEGAL CERT shpk ne fazen e ofertes;
6. te garantoje zbatimin e dispozitave ligjore qe kane ndikim mbi konformitetin e produktit/sherbimit objekt çertifikimi.

Çertifikimi ka te beje ne menyre ekskluzive me konformitetin e sistemit te menaxhimit me standardin referues; zbatimi i dispozitave ligjore ne fuqi eshte pergjegjesi ekskluzive e subjektit te audituar.

6.2. Kerkesa per çertifikim

Subjekti i interesuar per çertifikimin kerkon nje oferte nga LEGAL CERT shpk duke perdorur formularin e posaçem te publikuar ne faqen zyrtare te internetit www.legalcert.al, te plotesuar ne çdo pjese te tij.

Plotesimi i vertete i fushave te formularit (psh.: objekti i shoqerise, objekti i çertifikimit, perjashtime te mundshme, numri i pergjegjesve) dhe konsultimi i kesaj rregullore jane pergjegjesi ekskluzive e subjektit dhe gjithashtu perbejne kushte te domosdoshme per hartimin e ofertes; LEGAL CERT shpk ka te drejte te verifikoje permbajtjen e deklarates qofte gjate hartimit te ofertes, ashtu dhe gjate fazave qe do te pershkruhen ne vijim (Faza 1, Faza 2, mbajtja etj.).

Per çertifikimin e subjekteve te huaja, vlejne te gjitha kushtet qe rregullojne dhenien e çertifikimit per subjektet vendase, perveç dispozitave eventuale te posaçme, ne zbatim te marreveshjeve te lidhura nga LEGAL CERT shpk ne nivel nderkombetar.

6.3. Shqyrtimi i kerkeses per çertifikim dhe programi i auditit

Pergjegjesia per shqyrtimin e kerkeses i ngarkohet pergjegjesit te skemes per sektoret IAF qe ka kompetencen e duhur ne rastin kur nuk permbushet kriteri I kompetences kjo pergjegjesi I kalon Drejtorit Teknik per i cili, perveç se duhet te zoteroje njohuri te stardardeve referuese dhe rregulloreve te zbatueshme per dokumentacionin e sistemit te subjektit, duhet te kete njohuri per proceset prodhuese dhe sektorin mercologjik te subjektit te mundshem klient. Regjistrimi i shqyrtimit paraprak te kerkeses kryhet nepermjet modelit SI 04 "Rishikimi i dosjes se auditit rezultati/vleresimi" ne seksionin e rezervuar per pjesen paraprake.

Gjithashtu per cilindo klient, Organizmi kryen nje shqyrtim te kerkeses mbi te dhenat e marra nepermjet modlit SI-01 dhe nga shkembimi i informacioneve te detajuara (te regjistruara ne modelin SI4 ne seksionin e shqyrtimit paraprak) te cilat mund te jene te nevojshme per njohjen e te gjitha fushave te interesit te klientit dhe karakteristikat e pergjithshme te subjektit te tij, selive, te kompleksitetit teknologjik, te proceseve, te kontraktimit te jashtem te mundshem dhe sherbimeve te keshillimit per t'u siguruar se:

1. Te dhenat e marra jane te mjaftueshme per kryerjen e nje auditit te plote;
2. Te jene percaktuar dhe dokumentuar kriteret e çertifikimit;
3. Te jene zgjidhur te gjitha dyshimet eventuale ose pasigurite interpretative midis OVK-se dhe subjektit;
4. Te jete verifikuar zoterimi i kompetencave te pershtatshme per nje vleresim te vlefshem;
5. Te jene marre ne konsiderate te gjithe faktoret (p.sh. aspektet ligjore qe ndikojne ne produkt/sherbim, aspektet e sigurise, gjuha, etj.);
6. Te gjithe elementet e vleresimit te dokumentohen dhe regjistrohen.

Rezultati i vleresimit te kerkeses mund te jete nje vendim pranimi ose refuzimi. Ne rast refuzimi te kerkeses se çertifikimit ne vijim te shqyrtimit, OVK-ja do te duhet te dokumentoje arsyet dhe t'ia komunikojte ato subjektit.

Ne rast pranimi te kerkeses per çertifikim, pergjegjesi i skemes merr masa per hartimin e programit te auditit (i pranishem ne mod. SI4) dhe Drejtori Teknik percakton kompetencat e nevojshme per kryerjen e auditit dhe vendimin per çertifikim, duke dhene nje gjykim lidhur me menytrat dhe afatet e kryerjes se auditit i cili duhet te marre ne konsiderate faktoret e meposhtem:

- Fushen e zbatimit te çertifikimit te kerkuar,
- Kriteret e standardit te sistemit te menaxhimit te zbatueshem dhe perjashtimet e kerkuara;
- Permasat dhe kompleksitetin organizativ;
- Kontekstin teknologjik dhe legjislativ;

- Besimin ne burime te jashtme te veprimtarive te perfshira ne fushen e zbatimit te sistemit te menaxhimit;
- Rezultatet e auditeve te meparshme (veçanerisht ne rast ndryshimi te markes);
- Numrin e selive dhe komentet mbi selite e shumefishta;
- Vendndhodhjen e selive operative te jashtme;
- Disponibilitetin e vleresuesve te LEGAL CERT shpk te kualifikuar ne fushat teknike referuese;
- Te dhenat lidhur me konfliktet e mundshme te interesit;
- Lajmet dhe te dhenat publike (faqet e internetit, shoqatat e kategorise etj.)
- Rreziqet qe rrjedhin nga veprimtaria e vleresimit dhe çertifikimit.

Programi i auditit do te perfshije nje audit fillestar te kryer ne dy faza (faza 1 dhe faza 2), auditin e mbikeqyrjes ne vitin e pare (brenda 12 muajve nga data e fazes 2) ne vitin e dyte nje audit rïçertifikimi (rinovimi) dhe nje ne vitin e trete, i cili duhet te kryhet perpara perfundimit te çertifikates.

Gjatë fazës së rivlersimit LEGAL CERT shpk kryen një analizë të detajuar të fizibilitetit mbi mundësinë/fizibilitetin për të kryer aktivitetet e auditimit duke ndjekur procedurën: 1. Remote (ne distance); 2. Auditimi në terren; 3. Auditimi i miks (një pjesë në distancë dhe një pjesë në terren), duke raportuar rezultatet e këtij vlerësimi brenda listës së kontrollit të treguar në Formularin SI-04

Proceset e programimit, Planifikimit dhe Drejtimit të Auditimit në Remote rregullohen nga Udhëzimet e duhura Teknike dhe procedurat e funksionimit të përcaktuara nga LEGAL CERT shpk

6.4. Propozimi kontraktual per çertifikim

Ne vijim te vleresimeve te kryera sipas percaktimeve ne paragrafet e meparshme, LEGAL CERT shpk pergatit oferten financiare e cila ka vleren e propozimit kontraktor per çertifikim, duke plotesuar modelin SI 02 mbi bazen e tarifave ne fuqi si dhe duke percaktuar te gjithe elementet e programit te auditit per te gjithe ciklin e çertifikimit.

Oferta hartohet mbi bazen e te djenave te dhena nga subjekti lidhur me selite dhe permasat e ndermarrjes te deklaruar ne kerkesen per preventiv dhe qellimin e çertifikimit te shprehur.

Te dhenat e komunikuar do te jene objekt verifikimi nga PGKI, gjate mbledhjes se hapjes se Auditeve (çertifikim, mbajtje, rinovim, i jashtezakonshem), dhe, ne rast ndryshimi te te djenave te komunikuar gjate fazes se preventivit, mund te behet e nevojshme nje shtim dhe/ose reduktim i diteve te punes te parashikuara ne oferte, duke sjelle si rrjedhoje ndryshimin e dispozitave kontraktore.

Propozimi kontraktor per çertifikimin hartohet dhe dergohet nga LEGAL CERT shpk tek subjekti me nenshkrimin e perfaqesuesit te tij ligjor.

Ne te specifikohet:

- fusha e zbatimit te çertifikimit te kerkuar, selite objekt çertifikimi, numri i punonjesve dhe Kodi IAF i referimit;
- permbajtja e programit te te gjithe ciklit te çertifikimit te dalluar ne auditin fillestar qe duhet te kryhet ne dy faza, auditin i mbikeqyrjes se pare, mbikeqyrjes se dyte dhe i rïçertifikimit gjate vitit te trete;
- kostoja e çertifikimit fillestar i cili perfshin leshimin e çertifikates me percaktimin e afateve te auditit te shprehura ne dite pune;
- kostoja e auditeve te mbikeqyrjes i cili percakton afatet e auditit te shprehura ne dite pune;
- kostoja e auditeve te rinovimit ku percaktohen afatet e auditit te shprehura ne dite pune;
- kostoja eventuale e cila lidhet me rimbursimin e shpenzimeve sipas listes (udhetim, ushqim dhe akomodim nese eshte e nevojshme) e GA te ngarkuar me Auditin;
- kushtet kontraktore dhe kriteret minimale te domosdoshme per kryerjen e auditit fillestar dhe auditit te çertifikimit.

Kostoja ekonomike e veprimtarisë së certifikimit është në përpjesëtim me numrin e ditëve (dd) të përcaktuara për kryerjen e audit në sistemin e menaxhimit të organizatës dhe nivelin e kompleksitetit/rezikut sipas udhëzimeve të përcaktuara në MD të zbatueshme, detajet e tyre janë përfshirë nga LEGAL CERT shpk në tarifatat për skemat e ndryshme të certifikimit.

Propozimi është i vlefshëm normalisht për 30 dite duke filluar nga data e nisjes së tij nga ana e LEGAL CERT shpk.

Me propozimin kontraktor i komunikohet gjithashtu subjektit të konsultojë REG-01 Rregulloren për Çertifikimin LEGAL CERT shpk e publikuar në faqen zyrtare të internetit të LEGAL CERT shpk (www.legalcert.al) ose e kerkueshme pranë sekretarise, me kusht të subjekti të marrë persiper në rast pranimi të ofertes, të permbushë gjithçka parashikohet në të.

Me nënshkrimin e propozimit kontraktor, subjekti garanton zbatimin e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me realizimin e produktit/shërbimit objekt i kontrates së certifikimit.

Subjekti klient i Legal Cert shpk ka për detyrë të lejojë kryerjen e auditit krahas inpektoreve të entit akreditues, në rastin kur DA-ja shqiptare e konsideron të nevojshme, refuzimi i të cilit duhet të sjellë për pasoje shfuqizimin e certifikimit të akredituar.

6.5. Pranimi i kërkesës për certifikim

Subjekti i cili ka për qëllim që të pranojë propozimin kontraktor për certifikim nënshkruar përmbajtjen duke vendosur firmën në fund të dokumentit si dhe nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor të ose të personit të autorizuar në këto funksion.

Pranimi i propozimit nga ana e subjektit përben formalizimin ligjor të kontrates së certifikimit dhe, me nënshkrimet përkatëse dhe vulat, verteton pranimin zyrtar të përmbajtjes së kësaj Rregulloreje nga ana e subjektit si dhe pranimin e dispozitave kontraktore.

LEGAL CERT shpk, me marrjen e propozimit të nënshkruar nga subjekti dhe të pranuar nga drejtoria, merr masa për planifikimin e veprimtarisë së certifikimit sipas menyrave të rena dakord me subjektin dhe zakonisht brenda një periudhe prej 4 – 6 javësh nga marrja e tij.

LEGAL CERT shpk kryen vlerësimin e kontrates, duke kontrolluar përputhshmerinë e ofertes së dërguar dhe asaj të marrë. Në rast se nuk ka mospërputhshmeri hapet një dosje të ciles i caktohet numri identifikues i dosjes. Në rast ndryshimesh midis ofertes së dërguar dhe asaj të marrë, Drejtoria kontakton subjektin për të sqaruar këto mospërputhje.

Në rast se ndryshimet e propozuara nga subjekti nuk janë të pranueshme për çdo lloj arsye, Drejtoria e LEGAL CERT shpk informon me shkrim subjektin lidhur me arsyet e mospranimit.

Çdo ndryshim lidhur me sa është përcaktuar në kontratë nga subjekti (psh.: ndryshim i numrit/vendndodhjes së selive të shoqërisë, numri i përgjithshëm i punonjësve, kompleksiteti i proceseve etj.), e identifikuar në çdo fazë të procesit të certifikimit, mund të shkaktojë ndryshim të planifikimit të Auditit të përcaktuar si dhe ndryshim financiar për të cilin duhet të bihet dakord midis LEGAL CERT shpk dhe subjektit.

Vlefshmeria e kontrates është tre vjeçare; në përfundim, në rast rinovimi të kryer sipas menyrave të përshkruara në vijim, kontrata do të konsiderohet e rinovuar në mënyrë të heshtur për një afat tjetër tre vjeçar, përveç kur secila prej palëve, nepermjet një njoftimi me shkrim prej gjashtë muajsh i komunikon palës tjetër vullnetin e kundërt.

Në rast se në momentin e rinovimit të heshtur të kontrates ekzistojnë ndryshime të cilat për nga natyra e tyre (numri i punonjësve, fusha e zbatimit, numri i selive, zgjerimi dhe/ose reduktimi i objektit, dispozita të reja ligjore etj) mund të shkaktojnë ndryshime edhe të natyrës financiare, këto, së bashku me arsyet përkatëse, do t'i komunikohen subjektit dhe do të jenë objekt pranimi.

6.6. Auditit paraprak (auditit paraprak fakultativ)

Objekti i auditit paraprak konsiston ne identifikimin e pikave te dobeta te dokumentacionit dhe ne zbatimin e sistemit te menaxhimit. Kjo veprimtari mund te perfshije vleresimin e dokumentacionit te sistemit te menaxhimit (katalog, procedura, udhezime eventuale) ose te kryhet vecmas, mbi bazen e asaj çka eshte rene dakord me subjektin.

LEGAL CERT shpk kryen vetem nje audit paraprak, perpara fillimit te procesit te çertifikimit me kerkese te subjektit, me qellim vleresimin e aftesise se tij per te perballuar procesin e çertifikimit, moszbatueshmerine e mundshme te kritereve te posaçme ligjore lidhur me sistemin dhe zbatueshmerine e mundshme te standardeve dhe kritereve ligjore lidhur me produktin dhe sherbimin.

Kjo veprimtari mund t'i lejoje subjektit qe te qartesoje fushen e zbatimit te sistemit te tij te menaxhimit, te identifikojë konstatime te mundshme ne dokumentacion dhe/ose ne zbatimin e sistemit te menaxhimit ne perputhje me standardet referuese që i nënshtrohen objektit te çertifikimit.

Menyrat e kryerjes se auditit paraprak jane objekt marreveshje financiaro/teknike rast pas rasti midis subjektit klient dhe LEGAL CERT shpk; auditit paraprak duhet te kryhet perpara fillimit te procesit te çertifikimit dhe mund te perfshije nje vleresim paraprak te dokumentacionit prane zyrave te LEGAL CERT shpk ose prane subjektit.

Rezultatet e auditit paraprak regjistrohen nga PGA ne nje raport te posaçem, kopje e te cilit i dorezohet subjektit dhe origjinali mbahet nga LEGAL CERT shpk. Rezultatet, duke marre parasysh menytrat e kryerjes se auditit, jane vetem indikative. Subjekti eshte i lire te vendose nese dhe kur te vazhdoje me procesin e çertifikimit ose te nderprese raportin kontraktor pas auditit paraprak.

Kjo veprimtari nuk mund te konsiderohet pjese e procesit te çertifikimit dhe prandaj kryerja e saj e mundshme nuk zvogelon kohezgjatjen e auditit te çertifikimit.

Kopja e raportit qe i leshohet subjektit nga PGA i ngarkuar, ruhet ne dosjen perkatese; ky raport, ne çdo rast nuk ka ndikim mbi rezultatin e auditit te metejshem te çertifikimit.

Veprimtaria e auditit paraprak e pershkruar ne kete paragraf mund te kryhet nga LEGAL CERT SHPK vetem nje here per çdo subjekti dhe vetem me kerkese me shkrim te vete subjektit.

6.7. Planifikimi i auditit

Te gjitha veprimtarite e procesit te vleresimit kryhen sipas rregullave te percaktuara nga standardi ISO/IEC 17021 i zbatueshem.

LEGAL CERT shpk, me marrjen e propozimit kontraktor te nenshkruar nga subjekti dhe te pranuar nga Drejtoria, merr masa per vleresimin e kerkeses se çertifikimit duke vleresuar:

- Plotesine e te dhenave lidhur me subjektin, te nevojshme per kryerjen ne menyre korrekte te auditit;
- Kuptimin e kritereve te çertifikimit nga ana e subjektit;
- Mungesen e dyshimeve lidhur me interpretimin e menyrave te kryerjes se veprimtarise;
- Fushen e zbatimit te çertifikimit te kerkuar dhe zoterimin e kritereve profesionale te nevojshme;
 - Percaktimin e elementeve eventuale plotesues te dobishem (aspektet e sigurisë, kërcënimet e paanshmërisë, aspektet e mbrojtjes së mjedisit, etj.)

Planifikimi i veprimtarive te çertifikimit kryhet sipas menyrave te rena dakord me subjektin brenda nje periudhe prej rreth prej 3-6 javesh nga pranimi i kontrates.

Pergjegjesi per praktiken, pasi bie dakord me subjektin lidhur me periudhen e mundshme te kryerjes se veprimtarive te vleresimit, kerkon dokumentacionin e sistemit te menaxhimit (katalogun e cilesise dhe listen e procedurave) te nevojshem per plotesimin e dosjes, duke komunikuar njekohesisht emrat e personave te ngarkuar per kryerjen e veprimtarive te auditit.

Subjekti, brenda 5 diteve nga marrja e komunikimit, mund te refuzoje GKI nepermjet nje komunikimi me shkrim drejtuar LEGAL CERT shpk se bashku me arsyet perkatese. Ne kete rast, LEGAL CERT shpk, ne rast se i pranon arsyet, do te marre masa per te ngarkuar nje vleresues tjeter dhe t'i komunikojë emrin e tij subjektit; perndryshe GKI mbetet

i konfirmuar ne baze te parimit te “Miratimit te Heshtur”.

LEGAL CERT shpk percakton Planin e Kontrolit Inspektues, fazen 1, dukei komunikuar sbjektit:

- datat dhe oraret e percaktuar per pjesen e pare te auditit fillestar (faza 1) si dhe vendet e kryerjes se ketyre veprimtarive;
- konfirmon perberjen e GA (Pergjegjesin e Grupit te Auditit, vleresuesit, ekspertet teknike, monitoruesit eventuale);
- kriteret dhe objektivat e auditit;
- fushen e zbatimit dhe proceset objekt auditit.

Subjekti, brenda 2 diteve nga marrja e komunikimit, mund te kerkoje nje ndryshim te arsyetuar te planifikimit te bere.

Anullimi dhe/ose kerkesa per shtyrje e auditit qe i komunikohet LEGAL CERT shpk me nje paralajmerin me te shkurter se 7 dite, sjell si pasoje debitimin e 50% te shumes se pergjithshme te ketij auditit.

Ne çdo rast, ne mungese te ndonje komunikimi, planifikimi i auditit dhe GA mbeten te konfirmuar, ne baze te parimit te “Miratimit te Heshtur”.

6.8. Auditi Fillestar: FAZA 1

Faza e pare e auditit fillestar konsiston ne nje vleresim te konfromitetit te dokumentacionit te sistemit te menaxhimit te klientit me standardin referues dhe ne nje vleresim te pergjithshem te ketij sistemi; mund te parashikohet vizita e selise/ve objekt çertifikimi si dhe kryerja e intervistave per personelin nga ana e grupit te auditit.

Faza 1 zakonisht kryhet prane selise se subjektit (*on site*), pervec subjekteve te permasave te vogla, me procese produktive te thjeshta dhe perseritese, per te cilat, pas nje vleresimi te kujdesshem fillestar eshte e mundur kryerja e veprimtarive qe kane te bejne vleresimin e dokumentacionit prane selise se organizmit (*off site*).

Objekti i veprimtarise se vleresimit ne Fazen 1 eshte ai i krijimit te sigurise se arsyeshme persa i perket pjekurise dhe plotesise se sistemit te menaxhimit te zbatuar nga subjekti: niveli i perfshirjes se burimeve te shoqerise, proceset prodhuese te subjektit dhe kompleksiteti i tyre, ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Nderkohe merren te gjitha te dhenat e nevojshme per nje kryerje efikase te auditit te Fazes 2 (kapaciteti i nevojshem, afatet e auditit, marrja e mostrave, selite, etj.).

Vleresimi i dokumentacionit konsiston ne shqyrtimin e dokumentacionit te sistemit te menaxhimit te subjektit. Kjo veprimtari kryhet mbi bazen e kriterëve te standardit referues dhe ka per objekt verifikimin e plotesise se dokumentacionit si dhe permbushjen e te gjithe kriterëve te standardit.

Ky dokumentacionit ka te beje me:

- Politiken e shoqerise;
- Dokumentacionin e Sistemit (Katalogun e sistemit te menaxhimit, pro,cedura, informacione të dokumentuar udhezime etj.);
- Pershkrimin e shoqerise dhe proceseve te saj;
- Informacione lidhur me licencat/lejen/autorizimet;
- Dokumentet e regjistrimit (psh. Regjistrimet lidhur me raportet e auditit te brendshem, vleresimet e drejtorise, veprimet korrekutese dhe parandaluese, mosperputhshmerite, ankesat).

Faza e pare i lejon gjithashtu subjektit marrjen e sqarimeve lidhur me Fazen e dyte dhe te gjithe procesin e çertifikimit, si dhe identifikimin e mungesave eventuale ne zbatimin e sistemit te menaxhimit.

Gjate fazes 1, sistemi i menaxhimit te subjektit duhet te jete nderkohe operativ; veçanerisht duhet te jete kryer te pakten nje velresim nga ana e drejtorise dhe nje cikël i plote auditit te brendshem. Gjithahtu duhet te jete e disponueshme nje liste me kriteret ligjore te zbatueshme per produktin dhe/ose sherbimin e ofruar nga subjekti.

Gjate Fazes 1 percaktohen:

- Shkalla e pergatitjes se subjektit per fazen 2 te auditit fillestar,
- Pershtatshmeria e sistemt te menaxhimit te zbtuar nga subjekti,
- Percaktimi i zinxhirit dhe nderveprimit te proçeseve.

Gjithashtu, vleresohet planifikimi dhe kryerja sistematike e auditeve te brendshme si dhe shqyrtimi nga ana e drejtorise.

Mblidhen dhe shqyrtohen informacionet dhe te dhenat qe kane te bejne me:

- Fushen e zbatimit te sistemit te menaxhimit;
- Proçeset dhe lokalizimi/et i/e klientit, te selive vepruese dhe prodhuese te çertifikueshme, perfshire aspektet perkatese ligjore dhe rregulloret e perputhshmeria me to;
- Gjendjen dhe kuptimin nga ana e subjektit e kriterëve te standardit, duke i kushtuar vemendje te posaçme identifikimit te sherbimeve kyçe ose aspekteve, proçeseve, objektivave dhe funksionimit domethenes te sistemit te menaxhimit.

Ne perfundim te veprimtarise se vleresimit te Fazes 1, auditori leshon nje raport te posaçem permbledhes nepermjet te cilit identifikohen pikat e mundshme te dobta te cilat mund te klasifikohen si Mos Perputhshmeri gjate auditit te Fazes 2 dhe shpeh nje gjykim te vetin lidhur me sistemin e menaxhimit te zbatuar si dhe shkallen e zbatimit.

Raport i auditit duhet te permbaje nje mundesi planifikimi te veprimtarive te vleresimit te Fazes 2 ne rast se PGA e konsideron subjektin te gatshem per te perballuar pjesen e dyte te vleresimit. Subjekti duhet te marre masa per pikat e dobta te identifikuar perpara se te proçedohet me Fazen e dyte; ne rast se nuk zgjidhen pikat kritike, keto mund te klasifikohen si mos perputhshmeri gjate fazes 2.

Ne rast se gjate Fazes 1 konstatohen pika te dobta te tilla qe bejne te nevojshme, sipas gjykimit te PGA perseritjen e kesaj faze, ky gjykim do te formalizohet ne raportin e auditit.

Per percaktimin e afateve te fazes 1 dhe fazes 2 duhet te mbahen parasysh nevojat e shprehura nga klienti per zgjidhjen e konstatimeve te mundshme te identifikuar dhe ndermarrja e veprimeve korrektuese te nevojshme brenda nje afati te arsyeshem qe mund te percaktoje OVK-ja per korrigjimin e shkaqeve te ketyre konstatimeve.

Ne çdo rast raportet e auditit do te vleresohen nga organizmi i çertifikimit dhe, ne rast se ka mosperputhje ose ndryshime lidhur me vleresimet e shprehura, perfundimi do t'i komunikohet subjektit. Ne mungese te nje komunikimi brenda 15 diteve nga shqyrtimi, permbajtja e raportit do te konsiderohet e pranuar.

LEGAL CERT shpk rezervon mundesine te ndryshoje oferten financiare ne rast se verifikohen ndryshime domethenese lidhur me te dhenat e marra me 'Pyetesorin e marrjes se te dhenave' te plotesuar nga subjekti.

6.9. Auditi Fillestar - faza 2

Me mbylljen e fazes 1 te auditit fillestar dhe vleresimin pozitiv te sistemit te menaxhimit, mund te proçedohet me kryerjen e fazes 2 e cila konsiston ne vleresimin e konforitetit te sistemit te menaxhimit te klientit me standardin referues dhe/ose dispozitat ligjore te zbatueshme prane selise/ve objekt çertifikimi.

Ne baze te rezultateve te Fazes 1 percaktohet data brenda te ciles do te kryhet Faza 2 duke marre parasysh nevojat specifike te klientit per zgjidhjen e problemeve te mundshme te evidentuara dhe nevojat e LEGAL CERT shpk qe t'i dedikohet subjektit nepermjet venies ne dispozicion te burimeve te pershtatshme per kryerjen korrekte te tij.

Auditi i Fazes 2 duhet te kryhet brenda nje afati maksimal prej 6 muajsh nga auditi i Fazes 1.

Faza 2 do te kete te beje me te gjitha proçeset qe subjekti ka identifikuar dhe do te vleresoje te gjithë kriteret e zbatueshme te standardit referues per te cilin subjekti deshiron te çertifikohet.

Nepermjet veprimtarive te auditit te Fazes 2 duhet te perftohen te dhena te mjaftueshme lidhur me:

- Konformitetin me te gjitha kriteret e standardit referues ose dokument tjeter ligjor te zbatueshem per sistemin e menaxhimit;
- Monitorimin, matjen, konsolidimin dhe shqyrtimin e sherbimeve krahasuar me objektivat dhe qellimet thelbesore te ketyre sherbimeve;
- Sistemin e menaxhimit te klientit dhe sherbimet krahasuar me parashikimet ligjore;
- Mbajtjen nen kontroll te proçeseve te klientit;
- Auditet e brendshme dhe vleresimin nga ana e drejtorise;
- Pergjegjesine e drejtorise per politikat e klientit;
- Lidhjet midis kriterëve ligjore, politikes, objektivave dhe qellimeve te sherbimeve, krahasuar me te gjitha parashikimet ligjore te zbatueshme, me pergjegjesite, me kapacitetin profesional te personelit, me veprimitarite, me proçedurat, me te dhenat e sherbimeve, me rezultatet dhe perfundimet e auditeve te pjeses se pare.

Auditimi i çertifikimit kryhet në zyrën kryesore të veprimtarisë së Subjektit dhe në vendet e prodhimit të përhershëm dhe/ose të përkohshëm;

LEGAL CERT shpk zhvillon nje Plan Auditimi me qellim qe te programoje sistematikisht dhe qartesisht te gjitha aktivitetet qe do te zhvillohen dhe detyrat e sicilit auditues ne lidhje me kriteret dhe objektivat e Auditit.

Faza 2 i kushtohet teresisht vleresimit te funksionimit te sistemit te menaxhimit, duke vene ne plan te pare proçeset prodhuese dhe nepermjet tyre vëzhgimin e zbatimit te seciles kerkese te standardit referues.

Subjekti i audituar eshte i detyruar t'i siguroje GKI bashkepunim maksimal ne te gjitha fazat e zhvillimit te KI, duhet te lejoje aksesin ne zona ne te cilat zhvillohen aktivitetet qe i referohen fushes se zbatimit te kerkuar per çertifikim dhe te siguroje mundesine per te intervistuar personelin qe ushtron keto aktivite.

Subjekti duhet te vere ne dispozicion te grupit te auditit dokumentacionin e sistemit dhe informacionet e dokumentet qe pasqyrojne zbatimin. Gjithashtu duhet te garantoje qe GA te asistohet gjate auditit nga personeli i subjektit.

Prania eventuale e konsulentit duhet te autorizohet nga PGA dhe ai mund te marre pjese ne audit ne rolin e vëzhguesit te thjeshte dhe jo si pjesemarrës aktiv.

Ne perfundim te auditit pergjegjesi i grupit te auditit do te paraqese rezultatet dhe perfundimet e auditit tek Drejtoria dhe/ose perfaqesuesit e Drejtorise se subjektit.

Konstatimet klasifikohen ne:

Moskonformitet i madh (MK +): Legal Cert konstaton një MK i madh kur rezulton, nga dokumentacioni dhe/ose zbatimi i Sistemit të Menaxhimit, mospërbushja e një kriteri të përcaktuar nga standardi të cilit i bëhet referim EN ISO 27001, ISO 9001 etj, të kërkesave të detyrueshme ligjore, rregulloreve të LEGAL CERT shpk dhe rregulloreve te tjera te zbatueshme dhe qe mund te cenojne vlefshmerine dhe/ose funksionimin perveçse mund te ndikojne negativisht ne aftesine e sistemit te menaxhimit per te realizuar rezultatet e pritshme.

Moskonformitet i vogel (MK -): Legal Cert sinjalizon nje Moskonformitet i vogel kur rezulton se nuk eshte permbushur nje kriter i percaktuar nga standardi referues ISO/IEC 27001, ISO 9001 etj, nuk jane permbushur kriteret e percaktuara nga ligji, rregulloret e Legal Cert dhe rregulloret e Drejtorise se Akreditimit – edhe pse ky eshte tregues i nje sjellje te papershtatshme dhe qe ka nevojë per nje veprim korrektiv – i tille qe uk cenon vlefshmerine dhe/ose funksionimin e Sistemit te Menaxhimit ose qe nuk gjeneron dyshime serioze lidhur me zbatimin e kerkesave te parashikuara nga standardi per te cilin subjekti ka kerkuar çertifikimin.

Komente (KOM): një Konstatim i ngritur nga LEGAL CERT v klasifikohet si Koment kur verifikohet, sipas gjykimit të grupit të auditit (GA) mundësia e rekomandimeve ose e përmirësimeve në dokumentacionin dhe/ose zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Organizmit përveç rasteve të përputhshmërisë dhe vlefshmërisë së tij. Sa më sipër nuk është pasojë e një situatë të mungesës së përmbushjes së një kriteri, por ka për qëllim të parandalojë që kjo situatë të verifikohet (përsa kohë konsiderohet e mundshme) dhe/ose dhënien e udhëzimeve për përmirësimin e

funksionimit të Sistemit. Nuk kërkohet që subjekti të ndërmarrë asnjë veprim korigjues edhe pse gjatë auditit pasardhes do të verifikohet nëse Komentet kanë qënë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga ana e subjektit dhe për pasojë eventualisht të marra parasysht;

Grupi i auditit harton nje raport auditit ne te cilin parashtrohen: data dhe ora e zhvillimit te auditit dhe funksionet pergjegjese, si te grupit te auditit ashtu dhe te subjektit, treguesit ne lidhje me vendet dhe selite e audituara, qellimin e çertifikimit dhe standardin referues, perjashtimet e mundshme me arsyetimin perkates, provat objektive mbi te cilat do te merret vendimi i ardhshem mbi çertifikimin, pikat e dobeta te sistemit te menaxhimit te keqyrrur, kerkesat e standardit per te kampionuar ne programin tre vjeçar, nje permbledhje e aktiviteteve me konstatimet dhe klasifikimin e tyre, nje gjykim perfundimtar mbi çertifikimin e subjektit, rekomandimet lidhur me mbledhjen e pare te hapjes dhe ato ne lidhje me mbledhjen perfundimtare.

Eshte detyre e PGA qe t'i sqaroje subjektit se permbajtja e Raportit te Auditit do duhet te analizohet, vleresohet dhe miratohet nga Organizmi i Çertifikimit brenda 15 diteve nga dita e zhvillimit te auditit. Nese subjekti nuk do te marre asnje njoftim brenda afatit te cituar me pare, perfundimet e raportit te hartuar nga PGA do te cilesohen si te miratuara nga organizmi.

Ne rastin kur LEGAL CERT shpk nuk miraton raportin e Auditit te leshuar nga PGA te ngarkuar, duhet t'i dergoje subjektit klient nje raport te ri ne te cilin ilustron ndryshimet ne lidhje me te meparshmin dhe, per secilin ndryshim, jepen arsytet perkatese.

PGA gjate mbledhjes permbyllese duhet gjithashtu te theksoje nevojën qe subjekti te dergoje prane organizmit komentet dhe vendimet e tij ne lidhje me rezultatet (MK, KOM.) e konstatuara gjate ushtrimit te auditit.

PGA i komunikon gjithashtu subjektit se procesi i çertifikimit parashikon, pervec analizes se plote te praktikes nga ana e pergjegjesit te skemes se organizmit, vendimmarrjen mbi rezultatet (çertifikim, nevoje per nje audit shtese, mos çertifikim) nga ana e Organit Vendimmarres.

6.10. Veprime te metejshme pas auditit per çertifikim

Subjekti duhet te trajtoje te gjitha konstatimet e mundshme te njoftuara nga LEGAL CERT shpk ne auditin e saj me veprime korrektuese dhe plane permiresimi qe te jene koherente dhe te pershtatshme ne lidhje me nivelin e problematikes se konstatuar gjate auditit.

Konstatimet gjate audit te LEGAL CERT shpk jane:

1. Mos Konformitet (MK +):

Prania e Mos Konformiteteve te medha pezullon procesin e çertifikimit deri ne momentin kur LEGAL CERT shpk konstaton zgjidhjen dhe gjykon perputhshmerine e sistemit dhe rekomandon leshimin e çertifikates ose cileson si te vlefshme nje çertifikate te leshuar.

Zgjidhja e Mos Konformiteteve te medha perfshin fazat e meposhtme:

- a. Subjekti percakton veprimet korrektive per te zgjidhur MK + dhe i dergon ato tek LEGAL CERT shpk brenda 30 diteve nga data e auditit;
- b. LEGAL CERT shpk vlereson dhe kontrollon veprimet korrektive brenda 10 diteve nga marrja i tyre;
- c. Subjekti zbaton veprimet korrektive dhe njofton LEGAL CERT shpk lidhur me perfundimin e tyre duke derguar te dhenat objektive brenda tre muajsh nga data e konstatimit te Mos Perputhshmerise.

Ne rastin kur veprimet korrektive nuk zbatohen brenda afateve te percaktuara (maks. tre muaj) do te duhet te zhvillohet perseri auditit fillestar.

Ne rastin e perfundimit pozitiv te zgjidhjes se Mos Perputhshmerise, procesi i çertifikimit vazhdon me dergimin e dosjes ne Organin Vendimmarres per çertifikimin i cili, sipas gjykimit te tij, mund te kerkoje zhvillimin e nje auditit te jashtezakonshem.

- 2 MosKonformitet i vogel (MK-)

Ne rastin e pranise se MosKonformiteteve i vogel duhet te verifikohen dhe te miratohen nga LEGAL CERT shpk veprimet korrektive perkatese. Ky eshte kusht i nevojshem per perputhshmerin e sistemit dhe rekomandimin e leshimit te çertifikates ose cilesimit si te vlefshme te nje çertifikate te leshuar.

Zgjidhja e Moskonformiteteve i vogel perfshin hapat e meposhtem:

- a. Subjekti percakton veprimet korrektive per te zgjidhur MK- dhe i dergon ato tek LEGAL CERT shpk brenda 30 diteve nga data e auditit;
- b. LEGAL CERT shpk vlereson dhe kontrollon veprimet korrektive brenda 10 diteve nga dergimi i tyre, afat pertej te cilit veprimet korrektive do te konsiderohen te pranuar;
- c. Subjekti zbaton veprimet korrektive dhe LEGAL CERT shpk vlereson mbylljen dhe vlefshmerine perkatese ne rastin e Auditit te pare te Mbikeqyrjes.

Subjekti eshte i detyruar te zbatoje veprimet korrektive te sugjeruara brenda nje muaji nga data e konstatimit.

3 Komete (KOM)

Prania e komenteve nuk cenon vleresimin e konformitetit te sistemit dhe per rrjedhoje rekomandimi per leshimin e çertifikates ose vazhdimi i vlefshmerise se nje çertifikate te leshuar i dergohet Organit Vendimmarres.

Zgjidhjet e mundshme te komenteve mund te perfshijne:

- a. Subjekti ndermerr veprime te pershtatshme per te analizuar, vleresuar dhe eventualisht per te transpozuar komentet brenda dates se zhvillimit te auditit te mirembajtjes;
- b. LEGAL CERT shpk vlereson veprimet e ndermarra gjate auditit pasardhes te mirembajtjes dhe, nese i vlereson positive, vlereson te mbyllur komentin.

6.11. Leshimi i çertifikimit

Dosja e subjektit, pas verifikimit si nga ana e formes ashtu edhe e permbajtjes, qe kryhet nga Pergjegjesi i Skemes, i dergohet Organit Vendimmarres per vendimin perfundimtar lidhur me leshimin e çertifikimit.

Nese Organi Vendimmarres nuk ka ne perberjen e tij, kompetencen e nevojshme te kerkuar ne perputhje me qellimin e çertifikimit, vendimarrja do te behet ekskluzivisht ne baze te opinionit pozitiv nga ana e nje ose disa eksperteve teknike, te cilet te duhet te zoterojne kompetencat e nevojshme dhe te mos kene qene te perfshire ne aktivitetet e inspektimit.

Çertifikata leshohet brenda 20 diteve nga perfundimi i KI per çertifikim, me perjashtim te rasteve te meposhtme:

1. Ne rast mangesish ne dosje (p.sh.: ne rast mosderrgimi te propozimit per trajtim te kerkeses nga ana e subjektit) te konstatuara nga Organi Vendimmarres.
2. Ne rastin kur Organi Vendimmarres veren disa situata per te cilat mund te nevojitet zhvillimi i nje Auditit te Jashtezakonshem (prova jo te mjaftueshme, zgjidhje per mp jo koherente etj.)
3. Ne rastin kur konstatohen mosperputhshmeri gjate auditit. Ne kete rast, 20 ditet do te fillojne duke filluar nga data e perfundimit te procedures se analizes dhe vleresimit te veprimeve korrektive te sugjeruara dhe te zbatuara nga subjekti dhe pas shprehjes se mendimit pozitiv nga ana e Organit Vendimmarres.

Pas miratimit nga ana e Organit Vendimmarres te auditeve administrative, leshohet "Çertifikata e konformitetit" e firmosur nga Drejtori i Pergjithshem i LEGAL CERT shpk, e cila i dergohet subjektit ne origjinal, nepermjet postes se regjistruar (me njoftim per marrjen) se bashku me marken e çertifikimit dhe me Rregulloren per perdorimin e logos LEGAL CERT shpk ne versionin aktual dhe me vendimin e Organit Vendimmarres ne lidhje me planifikimin e auditeve te metejshme per mbajtjen e çertifikimit.

Çertifikata verteton konformitetin e sistemit te menaxhimit te dokumentuar dhe te zbatuar nga subjekti, ne lidhje me standardin referues, ne seline operative te vizituar gjate auditit.

Çertifikata eshte e vlefshme per 3 vjet ne rastin kur do te zbatohen disa kushte teknike dhe financiare te pershkruara

ne kete rregullore. Vlefshmeria e çertifikates fillon nga data e vendimit te Organit Vendimmarres; vlefshmeria e Çertifikates konfirmohet, çdo vit, me “Deklaraten e Vlefshmerise vjetore” qe leshohet nga LEGAL CERT shpk pas auditit te pare (1) dhe auditit te dyte (2) te mbikeqyrjes (mod. SI 28).

Organi Vendimmarres mund dhe te mos e miratoje leshimin e çertifikates, duke komunikuar arsyet perkatese, ne kete rast do te jete detyre e sekretarise t’i njoftoje subjektit arsyet qe kane diktuar kete vendim dhe te planifikoje nje Audit te Jashtezakonshem.

Çertifikata nuk do i dergohet subjekteve te cilat nuk kane permbushur detyrimin lidhur me pagesat.

Pas leshimit te Çertifikates, subjekti do te regjistrohet ne listen e subjekteve te çertifikuara LEGAL CERT shpk ne faqen zyrtare te saj ne internet www.legalcert.al.

Subjektet e çertifikuara nga LEGAL CERT shpk ne sektoret e mbuluar nga akreditimi i komunikohen Drejtorise se Akreditimit ne menyren e percaktuar nga kjo e fundit.

Pezullimi, heqja dore ose terheqja e mundshme e çertifikimit njoftohet nga LEGAL CERT shpk ne te njejten menyre si ajo e sipercituar.

Regjistrimet e Dorëzimit/Validimit të Certifikatës janë treguar në Formularin SI 04 " Rishikimi i dosjes se auditit rezultati/vleresimi “.

7. PROÇEDURA E MIREMBAJTJES

Aktivitetet qe zbatohen nga LEGAL CERT shpk per te zhvilluar mbikeqyrjen ne lidhje me mbajtjen e konformitetit me standardin e sistemeve te menaxhimit te subjektit klient jane:

- Audit ne seline dhe vendet prodhuese te organizates;
- Mbledhje e te dhenave dhe informacioneve prane klientit nepermjet dergimit te dokumentacionit te regjistrimit (edhe ne format elektronik);
- Analize e materialit publicitar te klientit (broshura; faqja e internetit, etj.)

LEGAL CERT shpk zbaton procedurat per mbajtjen çertifikimit te sistemeve te menaxhimit me qellim qe te verifikojë mbajtjen nga subjekti i çertifikuar te nje sistemi menaxhimi ne perputhje me kerkesat e standardeve referuese, perveç sigurimit te zgjidhjes efikase te mosperputhshmerive dhe/ose observimeve te konstatuara ne auditit paraardhes (çertifikimi fillestar, i mbikeqyrjes, i zgjatjes ose i rinovimit).

Konstatimet e paadministruara klasifikohen sipas nivelit me te larte ne kuptim te ashpersise (komentet behen MK-, MK- behen MK+)

Auditet e mirembajtjes jane 2 dhe zhvillohen çdo vit bazuar ne programin e auditit te percaktuar nga organizmi ne shqyrtimin e kerkeses per çertifikim, ne menyre qe te mbuloje ne harkun e trevjeçarit kontraktual te gjithë sistemin e menaxhimit te subjektit; ky program i komunikohet subjektit gjate ofertes dhe rishikohet ne vazhdimesi ne raportin e auditit.

Auditet e mbikeqyrjes duhet te zhvillohen te pakten nje here ne vit. Data e auditit te pare te mbikeqyrjes te zhvilluar pas auditit fillestar nuk duhet te kaloje 12 muaj nga dita e fundit e fazes 2 te auditit fillestar.

Auditet e mepasme ne periudhen kontraktuale zhvillohen pas 24 muajsh mbajtja e dyte dhe 36 muaj ai per rinovimin, duke i llogaritur nga dita e fundit e fazes 2 te auditit fillestar.

Ne asnje rast periudha e vlefshmerise se çertifikates nuk mund te tejkalojë 36 muaj.

Gjate auditeve te mbikeqyrjes sistemi i nenshtrohet ne menyre te pergjithshme auditeve te pjesshme, duke garantuar nje vleresim te plote te sistemit te menaxhimit ne harkun e periudhes se vlefshmerise trevjeçare; çdo audit mbikeqyrje ka per objekt kryesisht çeshtjet e meposhtme:

- Veprimet e ndermarra ne vijim te konstatimeve te identifikuar ne auditin e meparshem;
- Auditet e brendshme dhe shqyrtime nga ana e drejtorise;

- Trajtimin e ankesave;
- Efikasitetin e sistemit te menaxhimit ne arritjen e objektivave te klientit te çertifikuar;
- Progresin e aktiviteteve te planifikuara, te perfunduara ne lidhje me permiresimin e vazhdueshem;
- Mbajtjen nen kontroll te vazhdueshem te aktiviteteve;
- Shqyrtimin e çdo ndryshimi;
- Perdorimin e çertifikates, te markes se OVK-se dhe te çdo referimi tek çertifikimi

Auditi zhvillohet sipas kriterëve dhe menyrave te pershkruara ne kete rregullore.

Ne rastin e evidentimit te Moskonformiteteve do te ndiqen rregullat e parashikuara per auditin e çertifikimit, ku, ne vend qe te proçedohet me leshimin e çertifikimit, mund te kerkohet heqja ose pezullimi i tij (te shikohen paragrafet ne vijim).

Gjate auditeve te mirembajtjes GA duhet te verifikojë nese kane ndryshuar kushtet te cilat kane percaktuar leshimin dhe mbajtjen e çertifikimit ne periudhen nga auditin i meparshem.

PGA formulon, ne raportin e auditit, nje vleresim te tij ne lidhje me vazhdimesine e konformitetit te sistemit te menaxhimit te vleresuar dhe, nese e cileson te nevojshme, i kerkon subjektit te rivleresoje provat dhe perfundimet e auditit.

Nese nje subjekt i çertifikuar nuk deshiron t'i nenshtrohet nje auditin mbikeqyrje, pa arsye te justifikuar, duhet ta komunikojë formalisht te pakten 3 muaj para dates se vendosur per zhvillimin e auditit. Kjo nenkupton prishjen automatike te kontrates se çertifikimit me LEGAL CERT shpk dhe sjell anulimin dhe terheqjen e menjehershme te çertifikates.

LEGAL CERT shpk mund te kerkoje pagesen e shumes se parashikuar ne oferte per mbikeqyrjen e pa zhvilluar, ne rastin kur komunikimi i prishjesh se kontrates nuk behet 3 muaj para dates se vendosur per zhvillimin e mbikeqyrjes (konkretisht 12, 24 ose 36 muaj nga dita e fundit e Fazes 2 te auditit fillestar).

Ne perfundim te auditit te mbikeqyrjes 1 dhe 2, LEGAL CERT shpk i dergon subjektit, nepermjet postes se çertifikuar, "Deklaraten e vlefshmerise vjetore" (mod. SI 28) te cilen klienti do duhet t'ia bashkelidhe Çertifikates se konformitetit qe ka ne zoterim, si vertetim te rezultatit pozitiv te mbikeqyrjes vjetore.

8. AUDITI I JASHTEZAKONSHEM

LEGAL CERT shpk mund te planifikojë nje Audit shtese/te jashtezakonshem (A-STR), ne rast:

1. Pranie te mosperputhshmerive serioze te konstatuara gjate Auditit te çertifikimit/mbajtjes, trajtimi i te cilave nuk garanton besueshmeri ne lidhje me efikasitetin e veprimeve korrektive te ndermarra;
2. Kerkese te arsyetuar te Drejtorit Teknik;
3. Njoftime/ankesa te marra nga LEGAL CERT shpk mbi subjektin ose nga vete subjekti;
4. Ndryshime organizative/te shoqerise te njoftuara per LEGAL CERT shpk nga subjekti;
5. Kerkesa per zgjerim/zvogelim te çertifikimit;
6. Proçedura te pezullimit/heqjes se çertifikimit;
7. Riformatim i praktikave te çertifikimit si pasoje e konstatimeve te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit per LEGAL CERT shpk;
8. Kerkese nga ana e DPA;
9. Kerkesa specifike nga ente shteterore te ngarkuara me zbatimin e legjislacionit se detyrueshem ne ate fushe;
10. Raste te tjera te arsyetuara.

Auditet e jashtezakonshme vendosen, planifikohen dhe i komunikohen subjektit me shkrim nga LEGAL CERT shpk nepermjet nje njoftimi paraprak prej 15 ditesh. Llojet e dokumentacionit te auditeve te jashtezakonshme jane te njejta me ato qe parashikohen per Auditin e çertifikimit/mbajtjes.

Per rastin 1, ky audit eshte i kufizuar ne konstatimin e mbylljes se moskonformiteteve te medha, duke marre ne konsiderate edhe moskonformitetet te vogla te mundeshme te konstatuara.

Ne rast se audit i jashtezakonshem rezulton negativ, aktivizohet proçedura e pezullimit te parashikuar ne paragrafin 12 ne vijim, per subjektet e çertifikuara, ndersa anulohet proçedura per subjektet qe jane ne proçes çertifikimi te cilat nuk do mund te riformulojne kerkese per çertifikim per nje periudhe 3 mujore nga data e auditit te jashtezakonshem.

Kostot shtese te auditeve te jashtezakonshme jane ne ngarkim te subjektit.

9. PROÇEDURA E RINOVIMIT TE ÇERTIFIKIMIT

Auditi i Rinovimit eshte i detyrueshem per vazhdimesine e vlefshmerise se Çertifikimit. Ai ka per qellim te analizoje te gjithë sistemin e menaxhimit per te vleresuar nese klienti i çertifikuar ka mbajtur nje sistem menaxhimi ne perputhje me kerkesat e standardit referues dhe te kesaj rregulloreje. Qellimi i Auditit te Rinovimit te çertifikimit eshte qe te konfirmoje konformitetin e vazhdueshem dhe efikasitetin e sistemit te menaxhimit ne kompleksitetin e tij, gjithashtu dhe perkatesine dhe zbatueshmerine e fushes se çertifikimit.

Auditi i Rinovimit te çertifikimit duhet te zhvillohet brenda 3 viteve nga data e perfundimit te Fazes 2 te auditit fillestar, duhet te marre ne konsiderate performancen e sistemit te menaxhimit per kohezgjatjen e periudhes se çertifikimit dhe duhet te perfshije rivleresimin e raporteve te meparshme te auditeve te mbikeqyrjes dhe te ankesave.

Proçedura per rinovimin e çertifikimit fillon ne menyre te heshtur, me perjashtim te rastit kur subjekti paraqet nje anulim formal te pakten gjashte muaj perpara perfundimit te çertifikates.

Ne fazen e planifikimit te auditit te rinovimit, organizmi kujdeset te marre nga subjekti konfirmimin e te dhenave fillestare ne menyre qe te vleresoje pranine e devijimeve te mundshme ne lidhje me qellimin e çertifikimit, te standardeve te aplikueshme, te numrit te punonjesve (te brendshem ose te jashtem), te vendeve te ushtrimit te aktivitetit, si dhe te çdo informacioni te nevojshem per te percaktuar ndryshimet ne lidhje me kontraten ne teresi. Ne rastin kur do te verifikohen rrethana qe do te prodhojne ndryshime te natyres financiare, organizmi duhet te njoftoje subjektin i cili do te mund te pranoje kushtet e reja.

Planifikimi i Auditit te Rinovimit te çertifikimit duhet te parashikojë auditin e te gjithë sistemit dhe te aktiviteteve qe perfshihen ne objektin e çertifikimit. Ne rastin kur do te verifikohen ndryshime te rendesishme ne sistemin e menaxhimit te klientit, ne aktivitetet e zhvilluara ose ne kontekstin ne te cilin operon sistemi i menaxhimit (p.sh. ndryshime te legjislacioneve) audit mund te zhvillohet ne dy Faza si per auditet fillestare.

Programi i auditit duhet te kete parasysh raportet e meparshme te auditit te hartuara gjate auditeve te kryera gjate te gjithë ciklit te çertifikimit dhe te konstatimeve te evidentuara dhe per me teper, ne rastin e subjekteve me vendndodhje te shumefishta ose me shume çertifikime, nje kampionim te pershtatshem te mbullimit ne terren.

Auditi i rinovimit duhet te cilesohet edhe si akti perfundimtar per trevjeçarin e kaluar, edhe si baza per nisjen e trevjeçarit vijues. Pavaresisht nga data te vendimit efektiv per Rinovimin e Çertifikimit, qe duhet te ndodhe para dates se perfundimit te Çertifikates ne fjale, LEGAL CERT shpk do te garantoje vazhdimesine kohore te programimit trevjeçar dhe te çertifikatave te leshuara.

Regjistrimi i rivleresimit te te dhenave per planifikimin e auditit te rinovimit konsiston ne Mod. SI4 Rishikimi i dosjes se auditit rezultati/vleresimi.

10. VEREJTE ME SHKRIM
